

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5615
E martë, 30 tetor 2018
çmimi 0.40 €

Në Stamboll inaugurohet aeroporti më i madh në Evropë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", TOMË GASHI | FAQE 4-5

Sylejman Selimi po mbahet në burg me prapavijë politike



Avokati Tomë Gashi ka bërë me dije se pa aktgjykim të plotfuqishëm mbajtja e klientit të tij, Sylejman Selimit, në vuajtje të dënimit, është shkelje e Kodit Penal, e Kodit të Procedurës Penale, e Kushtetutës së Kosovës si dhe e të gjitha konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të cilat Kosova i ka inkorporuar në sistemin

juridik. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Selimi është duke u mbajtur në burg për arsye me prapavijë politike. Gashi ka theksuar se ekipi mbrojtës po bën çdo gjë në aspektin juridik që Selimi të lirohet sa më shpejt por, sipas tij, ai po mbahet në vuajtje të dënimit inekzistent pa aktgjykim të plotfuqishëm

LIDERËT INSTITUCIONALË SHPREHIN OPTIMIZËM SE
VENDIMMARRJA E BASHKIMIT EVROPIAN (BE) PËR
LIBERALIZIM TË VIZAVE DO TË NDODHË KËTË VIT

Haradinaj: Lajmi i mirë për vizat, këtë vit

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, beson se lajmi i mirë për liberalizimin e vizave do të vijë para festave të fundvitit. Ai të hënën e ka ftuar opozitën ta ndihmojë këtë proces dhe të mos shprehë pesimizëm. Ndërsa Instituti EPIK i ka kritikuar deklarimet e liderëve institucionalë të Kosovës të cilët kanë premtuar lëvizje pa viza për qytetarët e Kosovës deri në fund të vitit 2018 | FAQE 3



**LDK-ja e pranon
se nuk mund
ta rrëzojë
Qeverinë, i
kërkon dorëheqje**

| FAQE 5

AKTUALE

**NËSE KA
INTERES, HASHIM
THAÇI MUND T'I
PROVOKOJË
ZGJEDHJET E
PARAKOHSHME!**



Behxhet
Sh. SHALA -
BAJGORA

F. 12

**KOSOVA E KËRKON
MBËSHTETJEN E
GJERMANISË PËR
TRANSFORMIMIN E FSK-së** F. 7

**UNIFIKIMI I KURRIKULAVE
KOSOVË - SHQIPËRI,
MUNDËSI E MIRË** F. 7

EKONOMI

**PYLLËZOHEN 300
HEKTARË TOKË** F. 9

**REÇICA TAKON TË
RIATDHESUARIT, PËRFITUES
TË PROGRAMIT TË
VETËPUNËSIMIT** F. 9

KULTURË

**VIZITË OBJEKTEVE TË
TRASHËGIMISË KULTURORE
DHE FETARE** F. 14

SPORT

**NDRYSHON FLAMURTARI,
TASH I MJAFTON BARAZIMI
NDAJ DRITËS** F. 18

**U17-SHAT E KOSOVËS E
MPOSHTËN ZVICRËN** F. 18

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Vuçiçi: Serbia e gatshme për dialog me Kosovën në çdo situatë

BEOGRAD, 29 TETOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiçi, tha se Serbia është e gatshme për vazhdimin e dialogut me Kosovën në çdo situatë. "Serbia është e gatshme për vazhdimin e dialogut, edhe në situatën e

tensioneve të rritura politike dhe të sigurisë, sidomos për serbët e Kosovës", tha Vuçiçi në një takim me udhëheqësin e një delegacioni të Parlamentit Evropian, Eduard Kukan, të hënën në Beograd. Siç raporton

Shërbimi i Ballkanit i "Radios Evropa e Lirë", Vuçiçi e informoi Kukanin për arsyet e ndërprerjes së dialogut me Prishtinën, duke thënë se kjo e fundit nuk i ka përmbushur detyrimet e përcaktuara me

Marrëveshjen e Brukselit, sidomos rreth formimit të Asociacionit Të Komunave Me Shumicë Serbe.

Vuçiçi thuhet se shprehu shqetësimet e tij me synimin e Prishtinës për formimin e

Ushtrisë së Kosovës dhe tha se një gjë e tillë do ta destabilizojë situatën në rajon. Vuçiçi, po ashtu, tha se anëtarësimi i vendit të tij në Bashkimin Evropian paraqet prioritet në politikën e jashtme të Serbisë.

Në Stamboll inaugurohet aeroporti më i madh në Evropë

Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka bërë inaugurimin e aeroportit të ri të Stambollit, që është një prej aeroporteve më të mëdha në botë që është i ndërtuar në një sipërfaqe prej 76.5 milionë metrash katrorë. Në inaugurimin e këtij aeroporti mori pjesë edhe presidenti Hashim Thaçi



STAMBOLL, 29 TETOR - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka bërë të hënën inaugurimin e aeroportit të ri të Stambollit që është një prej aeroporteve më të mëdha në botë. Erdogani së bashku me liderët mysafirë pozuan para kamerave.

Kryetari i Kuvendit të Madh Popullor të Turqisë, Binali Yildirim, në fjalën e tij të hapjes tha: "Uroj që kjo vepër, që i përshatet përvjetorit të 95-të të Republikës, t'i sjellë dobi vendit, popullit dhe rajonit tonë". Ceremonia e inaugurimit u ndoq me interesim të madh edhe nga media ndërkombëtare. Gazetarët realizuan edhe reportazhe të shumta në lidhje me arkitekturën e cila

tërheq interesim të madh.

Në ceremoninë e inaugurimit ishin të pranishëm edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ai i Shqipërisë, Ilir Meta dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiçi. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, me ftesë të homologut turk Rexhep Tajip Erdogan, ka marrë pjesë në hapjen solemne të aeroportit të ri të Stambollit. Thaçi e ka bërë të ditur këtë përmes rrjetit social "Facebook", ku ka thënë se e ka uruar homologun Erdogan për hapjen e aeroportit i cili pritet të shndërrohet në aeroportin më të madh në botë. "Me liderë shtetesh në përrurimin e aeroportit të ri të Stambollit, i cili pritet të

shndërrohet në aeroportin më të madh në botë. Në emër të qytetarëve të Kosovës, presidentin Erdogan e urova edhe për Ditën e Republikës së Turqisë".

Edhe presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se ishte kënaqësi për të ta uroj presidentin e Republikës

së Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, për 95-vjetorin e themelimit të Republikës së Turqisë. "Kënaqësi e veçantë ta uroja presidentin e Republikës së Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, për 95-vjetorin e themelimit të Republikës së Turqisë, e njëkohësisht për inaugurimin e aeroportit të ri të madh të Stambollit", ka shkruar

presidenti Meta.

Aeroporti i Stambollit është i ndërtuar në një sipërfaqe prej 76.5 milionë metrash katrorë, ndërsa për hapjen e fazës së parë janë investuar gjashtë miliardë euro. Faza e dytë e këtij aeroporti pritet të përfundojë deri në vitin 2023.

Pas përfundimit të punëve, aeroporti do të përbëhet nga gjashtë pista të ndara me një kapacitet për 500 avionë, parking të hapur dhe të mbyllur me kapacitet 70 mijë automjete dhe në vit do t'u shërbejë rreth 200 milionë pasagjerëve.

Fluturimi i parë nga aeroporti që do të realizohet pas fjalimeve hapëse do të jetë në drejtim të Ankarasë më 31 tetor, me avionin e tipit "Boeing 777" të kompanisë turke "Turkish Airlines". Pas përfundimit të zhvendosjeve të duhura deri në fund të vitit, pritet që në aeroport në ditë të ulen dhe ngrihen 2 000 avionë, nga më shumë se 35 vende, ndërsa shërbimet e tyre do t'i ofrojnë 250 kompani ajrore.



Kuvendi i Maqedonisë, nesër debat për mandatin e Gruevskit

SHKUP, 29 TETOR - Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, ka dorëzuar te kryetari i Komisionit për Çështje të Mandateve dhe Imunitetit kërkesën e dërguar nga gjykata

për marrjen e mandatit të deputetit dhe ish-kreut të VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski.

Komisioni duhet të vendosë se a do të jetë i padenjë deputeti

Gruevski për ta kryer funksionin e deputetit pas vendimit për dënimin me burgim prej 2 vjetësh për blerjen e 'Mercedes'-it luksoz.

Kryetari i komisionit, Pavle

Bogoevski, ka konfirmuar se kërkesa i është dorëzuar atij dhe njoftoi se seanca në të cilën do të shqyrtohet kjo kërkesë duhet të caktohet për 15 ditë.



Liderët institucionalë shprehin optimizëm se vendimmarrja e Bashkimit Evropian (BE) për liberalizim të vizave do të ndodhë këtë vit

Haradinaj: Lajmi i mirë për vizat, këtë vit

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, beson se lajmi i mirë për liberalizimin e vizave do të vijë para festave të fundvitit. Ai të hënën e ka ftuar opozitën ta ndihmojë këtë proces dhe të mos shprehë pesimizëm. Ndërsa Instituti EPIK i ka kritikuar deklarimet e liderëve institucionalë të Kosovës të cilët kanë premtuar lëvizje pa viza për qytetarët e Kosovës deri në fund të vitit 2018

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 29 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka shprehur optimizëm se para fundvitit do të ketë lajme të mira për liberalizim të vizave. Pas takimit që ka pasur të hënën me kryetarin e Prishtinës, Shpend Ahmeti, ai ka pranuar se në këtë proces janë disa vështirësi që, sipas tij, do t'i kalojë Kosova. "Nuk ka asnjë arsye të jemi pesimistë në këtë proces, por duhet të bëjmë shumë punë. I kemi disa vështirësi dhe i dimë. Tani kemi fokusin e 20 nëntorit, anëtarësimin e Kosovës në Interpol. Pra, është mirë të rrimë të fokusuar në këtë temë. Mendoj se para ndërrimit të moteve do të marrim një lajm të mirë për liberalizimin e vizave", ka thënë Haradinaj. Ai ka treguar se shumë njerëz po bëjnë përpjekje ta ndihmojnë Kosovën në këtë proces.

Kryeministri Haradinaj i ka ftuar subjektet politike opozitare ta ndihmojnë këtë proces. "Më vjen mirë që shumë njerëz janë kyçur për çështjen e liberalizimit të vizave. Kryetari (Shpend Ahmeti) më tregoi se u ka shkruar socialdemokratëve evropianë që ta ndihmojnë liberalizimin e vizave. I kisha lutur të gjitha partitë politike, sidomos ato opozitare, që ta ndihmojnë këtë proces dhe të mos japin mesazhe pesimiste. Imagjinojeni nëse dikush nga partitë politike thotë mezi nuk po presim të bëhet liberalizimi i vizave, se krejt kemi për të ardhur te ju. Nuk është në rregull të

thotë kështu ndonjë deputet apo zyrtar i ndonjë partie. Pra, duhet të bëjmë kujdes", është shprehur Haradinaj.

Edhe kryetari i Komunës së Prishtinës, njëherësh kryetar i PSD-së, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se po punon për ta ndihmuar këtë proces. Ai ka treguar se disa deputetë të shteteve të BE-së që e kanë njohur Kosovën kanë votuar kundër liberalizimit të vizave. "Nëse e keni vërejtur votimin në Parlamentin Evropian, aty shihen se ka disa shtete që e kanë njohur Kosovën. Analiza tregon se po ta shikojmë një shtet si Italia, e shohim se shumica e deputetëve italianë kanë

votuar për, por deputetët e partisë Lega, që janë aktualisht pjesë e Qeverisë, kanë votuar kundër. Njëjtë sikurse edhe me deputetët austriakë", ka thënë Ahmeti. Ai i ka ftuar subjektet politike që liberalizimin e vizave mos ta shohin si garë elektorale. "Kjo tregon se ka një hezitim për shkak të zgjedhjeve parlamentare në maj për Parlamentin Evropian. Dhe kjo, si duket, është problematike për disa shtete. Megjithatë, më duhet të potencoj se nëse kjo shihet vetëm si temë elektorale, ku ne akuzohemi, ndërsa në fund qytetari i Republikës së Kosovës pëson, atëherë kjo nuk mund të jetë ndonjë fitore për opozitën e as ndonjë humbje e madhe për Qeverinë", ka thënë Ahmeti.

Ndërsa Instituti EPIK ka kritikuar deklarimet e liderëve institucionalë të Kosovës të cilët kanë deklaruar se liberalizimi i vizave do të ndodhë brenda këtij viti. Përmes një komunikate për medie ky insti-

tut ka vlerësuar se askush prej përfaqësuesve të BE-së nuk ka përmendur afate për liberalizim të vizave. "Kanë mbetur edhe gjashtë hapa deri në lëvizjen e lirë të qytetarëve. Pjesa kritike e këtyre hapave është votimi i plotësim-ndryshimit të Rregullores 539/2001 nga ana e Këshillit të Bashkimit Evropian. Po ashtu, bazuar në zhvillimet e kohës, EPIK pati komunikuar që nga muaji gusht se lëvizja e lirë për qytetarët tanë nuk mund bëhet këtë vit dhe njëkohësisht është argumentuar se skenari më pozitiv është që vendimmarrja për procesin e liberalizimit të vizave të përfundojë këtë vit, ndërsa qytetarët të lëvizin lirshëm në vitin 2019", është thënë në komunikatën e Institutit EPIK, duke shtuar se këtë fakt e ka vërtetuar edhe Peter Beyer, deputet gjerman nga CDU, anëtar i Komitetit të Punëve të Jashtme dhe koordinator për Marrëdhëniet Transatlantike në kuadër të MPJ-së gjermane. "Në ditët e

fundit zyrtarët e lartë të institucioneve kanë përdorur një gjuhë fajësuese, me elemente të urrejtjes etnike ndaj BE-së, në rast të mosliberalizimit të vizave deri në fund të këtij viti. Instituti EPIK i përcjellë me shqetësim këto deklarata dhe rikujton se asnjë përfaqësues i institucioneve të BE-së apo vendi anëtar asnjëherë nuk ka dhënë afate kohore për liberalizimin e vizave. Janë vetë përfaqësuesit institucionalë të Kosovës të cilët kanë ofruar premtime të paqëndrueshme kohore për liberalizimin e vizave", është theksuar në komunikatën e Institutit EPIK. Një ditë më parë deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje, Fitore Pacolli dhe Albulena Haxhiu, në një konferencë për medie kanë shprehur pesimizëm se vendimmarrja për liberalizim të vizave mund të ndodhë këtë vit. Madje, sipas tyre, për këtë duhet të japin përgjegjësi liderët institucionalë të cilët kanë premtuar se kjo do të ndodhë.



Nesër do të mbahet seancë e jashtëzakonshme për dialogun Kosovë - Serbi



PRISHTINË, 29 TETOR (ER) - Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës në mbledhjen e së hënës të drejtuar nga kryeparlamentari Kadri Veseli vendosi që seanca e jashtëzakonshme, sipas kërkesës së 42 deputetëve nënshkrues, të mbahet të mërkurën, më 31 tetor, me fillim në orën 10:00.

Kryesia vlerësoi se kërkesa i plotëson kushtet formale, ndërkaq temë e debatit do të jenë angazhimet e presidentit të Kosovës për përfshirjen e "shkëmbimit të territoreve" apo "korrigjim të kufijve" në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pas përfundimit të këtij debati,

Kuvendi do t'i vazhdojë punimet, përkatësisht votimin e pikave të mbetura nga seancat e nisura më 13 dhe 14 shtator, si dhe të asaj më 15 tetor, për të vijuar më pas me vazhdimin e seancës së 18, 19 dhe 25 tetorit. Në këtë mbledhje janë shqyrtuar një varg kërkesash dhe propozimesh drejtuar Kryesisë së Kuvendit.

**FLET PËR
"EPOKËN E RE",
TOMË GASHI**



Sylejman Selimi po mbahet në burg me prapavijë politike

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 29 TETOR - Avokati mbrojtës i Sylejman Selimit, Tomë Gashi, ka thënë të hënën se klienti i tij është duke u mbajtur padrejtësisht në burg. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Selimi është duke e vuajtur dënimin pa aktgjykim të plotfuqishëm. "Duke mos pasur aktgjykim të plotfuqishëm, mbajtja e Sylejman Selimit në vuajtje të dënimit është shkelje e Kodit Penal, e Kodit të Procedurës Penale, e Kushtetutës së Kosovës si dhe e të gjitha konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të cilat Kosova i ka inkorporuar në sistemin juridik", është shprehur Gashi. Sipas tij, Selimi është duke u mbajtur në burg për arsye me prapavijë politike. "Qëndrimi i Sylejman Selimit dhe i imi si avokat i tij është se nuk ka asnjë

Avokati Tomë Gashi ka bërë me dije se pa aktgjykim të plotfuqishëm mbajtja e klientit të tij, Sylejman Selimit, në vuajtje të dënimit, është shkelje e Kodit Penal, e Kodit të Procedurës Penale, e Kushtetutës së Kosovës si dhe e të gjitha konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të cilat Kosova i ka inkorporuar në sistemin juridik. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Selimi është duke u mbajtur në burg për arsye me prapavijë politike. Gashi ka theksuar se ekipi mbrojtës po bën çdo gjë në aspektin juridik që Selimi të lirohet sa më shpejt por, sipas tij, ai po mbahet në vuajtje të dënimit inekzistent pa aktgjykim të plotfuqishëm



arsye juridike për ta mbajtur atë në burg dhe të vetmet arsye janë me prapavijë politike, të cilat ai më së miri do t'i shpjegojë me rastin e lirimit të tij. Pas lirimit të z. Sylejman Selimi mund të flas haptas, me emra dhe mbiemra se kush qëndron prapa gjithë kësaj padrejtësie që është duke iu bërë atij", ka deklaruar avokati Gashi.

"Epoka e re": Z. Gashi, edhe më tutje klienti juaj, Sylejman Selimi, po mbahet në burg. Për çfarë arsye Gjykata Supreme nuk po e liron Selimin?

Gashi: Gjykata Supreme e Kosovës sipas vetë gjeneral Sylejman Selimit nuk po e liron atë, sepse ky rast ka motive politike dhe prapa aktgjykimit të mëhershëm me të cilin është dënuar Sylejman Selimi dhe të tjerët në rastin 'Drenica' kanë qëndruar arsyet politike. Nuk ka pasur asnjë arsye as që të dënohet Sylejman Selimi me deklaratë të

një personi me diagnozë të skizofrenisë, e cila është vërtetuar edhe nga ekspertët e psikiatrisë gjatë gjykimet. Rasti i z. Sylejman Selimi më 11 qershor 2018 është kthyer në rigjykim dhe rivendosje nga vetë Gjykata Supreme e Kosovës, duke i anuluar të gjitha aktgjykimet e mëhershme dënuese kundër tij. Që nga kjo datë nuk ka pasur asnjë arsye ligjore që z. Sylejman Selimi të mbetet në burg në vuajtje të dënimit pa aktgjykim të plotfuqishëm. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka anuluar edhe aktgjykimin e plotfuqishëm sa i përket rastit 'Drenica 2' dhe e ka kthyer rastin në Gjykatën Supreme të Kosovës për të vendosur lidhur për kërkesën e mbrojtjes së ligjshmërisë. Kryetari i Gjykatës Supreme gabimisht pretendon se Sylejman Selimi është në vuajtje të dënimit kinse me një aktgjykim tjetër e që në të vërtetë është

aktgjykim me të cilin është bërë bashkimi i dënimeve në rastet 'Drenica 1 dhe 2' dhe me vetë faktin se aktgjykimin në rastin 'Drenica 1' është anuluar në tërësi dhe rasti është kthyer në rigjykim dhe rivendosje. Aktgjykimin mbi bashkimin e dënimeve është faktikisht aktgjykim nul-ineksistent ngaqë nuk mund të qëndrojë kur nuk kemi fare aktgjykim të plotfuqishëm në këtë rast. Duke mos pasur aktgjykim të plotfuqishëm, mbajtja e Sylejman Selimit në vuajtje të dënimit është shkelje e Kodit Penal, e Kodit të Procedurës Penale, e Kushtetutës së Kosovës si dhe e të gjitha konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të cilat Kosova i ka inkorporuar në sistemin juridik.

"Epoka e re": Cilët janë hapat që do t'i ndërmerren tash e tutje sipas mbrojtës?

Gashi: Ne ekipi mbrojtës i z. Selimi, avokatët Gregor Guy Smith, Colleen Rohan dhe unë, jemi duke bërë çdo gjë në aspektin juridik që z. Sylejman Selimi të lirohet sa më shpejt që është e mundur ngaqë tanimë të gjithë e dinë se ai është duke u mbajtur në vuajtje të dënimit ineksistent, pa aktgjykim të plotfuqishëm.

"Epoka e re": Ju përmes një postimi në "Facebook" keni paralajmëruar publikimin e një dokumenti përmes të cilit pretendohet se kryetari i trupit gjykues ka thënë se 'nëse i dënojnë të akuzuarit (gjeneral Sylejman Selimin, Sami Lushtakun dhe 15 komandantë dhe ushtarë të tjerë të UCK-së) ai do të gjejë punë gjithkund në Bashkimin Evropian'. Çfarë do të thotë kjo për ju?

Gashi: Ne do të publikojmë dokumente me të cilat vërtetohet ajo që kemi deklaruar, se e ka thënë kryetari i trupit gjykues në rastin 'Drenica 1 dhe 2', gjyqtari Darius Selicki.

"Epoka e re": Ka rrezik që Selimi të mos lirohet fare meqë qëllimi i trupit gjykues qenka dënimi me ose pa fakte për përfitime të karrierës së tij?

Gashi: Qëndrimi i vet Sylejman Selimit dhe imi si avokat i tij është se nuk ka asnjë arsye juridike për ta mbajtur atë në burg dhe të vetmet arsye janë me prapavijë politike, të cilat ai më së miri do t'i shpjegojë me rastin e lirimit. Pas lirimit të z. Sylejman Selimi mund të flas haptas, me emra dhe mbiemra se kush qëndron prapa gjithë kësaj padrejtësie që është duke iu bërë atij.

"Epoka e re": Mos ju si avokat nuk po jeni i zoti të mbron Selimin në këtë betejë gjyqësore?

Gashi: Sa i përket zotësisë sime për ta mbrojtur Sylejman Selimin, është krejtësisht e kundërta. Ne kemi shkathtësi juridike që ta mbrojmë juridikisht Sylejman Selimin, por një gjë e tillë është pothuajse mision i pamundur kur gjykatat në Kosovë në raste të caktuara nuk i respektojnë qëllimisht aktgjykimet e veta.

LDK-ja e pranon se nuk mund ta rrëzojë Qeverinë, i kërkon dorëheqje

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 TETOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka bërë me dije se në mbledhjen e kryesisë së kësaj partie janë pajtuar të hënën për një angazhim maksimal për të gjithë qytetarët në mënyrë që proceset që i sjellin të arritura Kosovës të mos ndërpriten.

Në konferencën për media pas mbledhjes së kryesisë së LDK-së, Isa Mustafa ka kërkuar dorëheqjen e Qeverisë Haradinaj si dhe shpërbërjen e Kuvendit. "Kushtet janë pjekur që Qeveria të japë dorëheqje. Jemi të mendimit që Kuvendi të shpërndahet. Një Qeveri e cila merret vetëm me shpenzimet e buxhetit, me idetë e klientelizmit, është mirë që mos ta presë mocionin e mosbesimit, sepse edhe ai mocion, për shkak të interesave, po zhargitet", ka thënë Mustafa.

Ai ka thënë se dialogu me Serbinë mund ta zhvillojë një Qeveri e cila përfaqëson shumicën. "Konsiderojmë se dialogun mund ta zhvillojë vetëm një Qeveri që përfaqëson shumicën, më pas të shkojë në

Kuvend dhe të aprovohet edhe në Komisionin Evropian në mënyrë që Komisioni mos të ketë status neutral", është shprehur Mustafa, duke shtuar se LDK-ja mendon se Qeveria dhe presidenti nuk mund ta bartin këtë proces. "Qeveria meqë nuk e ka shumicën dhe presidenti meqë nuk e ka mandatin", ka thënë Mustafa. Duke folur për korrigjimin e kufirit me Serbinë, lideri i LDK-së ka theksuar se korrigjimi i kufijve nuk vjen fare në shprehje për shtetin e Kosovës. "Vlerësojmë se ndryshimi i kufijve nuk vjen fare në shprehje dhe as ndonjë krijesë me kompetenca ekzekutive", ka deklaruar Mustafa. Mustafa e ka hedhur poshtë ftesën e liderit të PDK-së, Kadri Veseli, për unifikim të spektrit politik të Kosovës rreth dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Ai (Veseli) nuk është strumbullar i këtyre çështjeve. Është vetëm spiker i Kuvendit dhe kryetar i një partie politike. Kadri Veseli nuk e ka kompetencën e unifikimit. Kjo i bie një institucioni tjetër që duhet ta bëjë këtë punë (presidentit), por i cili nuk e ka bërë sepse e ka filluar keq procesin", ka thënë Mustafa.



Haradinaj: Do t'i përkrah projektet e Komunës së Prishtinës pa asnjë kusht

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 29 TETOR - "Qeveria e vendit dhe unë si kryeministër pa asnjë kusht, që në fillim të marrjes së përgjegjësive, e kemi thënë publikisht se do t'i përkrahim temat që i ka kryetari i Komunës, që i ka kryeqyteti, në shërbim të interesave të qytetarëve dhe vendit, pa marrë parasysh partinë", kështu ka thënë të hënën kryeministri Ramush Haradinaj, pas takimit me kryetarin e Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti. Në këtë takim është biseduar për temat e mëdha, siç janë Ligji i Prishtinës, Pallati i Rinisë, Salla Koncertale, unaza e qytetit, shpronësimet dhe projekte të tjera që lidhen me kryeqytetin, për të cilat kryeministri Haradinaj ka thënë se, si produkte janë kryer, por se gjatë zbatimit ka ende punë dhe në këtë zbatim ka rol edhe qeveria nacionale. "Edhe pse këto projekte janë në

përgjegjësi të komunës, prapëseprapë zbatimi ndërlidhet me veprimet që duhet të ndërmarrin edhe ministrinë, sikurse është rasti për Policinë e kryeqytetit, e që Ministria e Punëve të Brendshme duhet t'i marrë disa përgjegjësi, apo rasti me spitalin e kryeqytetit, për të cilin Ministria e Shëndetësisë duhet t'i marrë përgjegjësitë", është shprehur Haradinaj, duke shtuar se edhe për unazën e qytetit janë gjetur disa veprime të cilat duhet t'i ndërmarrë Qeveria.

Në prononcimin para mediave, kryeministri Haradinaj ka siguruar se pa asnjë kusht, pa asnjë kalkulim të caktuar, temat e kryeqytetit do të përkrahen nga Qeveria, duke theksuar se në kryeqytet jeton një e treta e qytetarëve të këtij vendi.

Kryeministri Haradinaj ka falënderuar kryetarin Ahmeti që pa asnjë hezitim temat e mëdha i ka diskutuar dhe po i diskuton bashkë me ekzekutivin.

Ndërkaq kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti,



ka thënë se ky takim me kryeministrin Haradinaj është në kuadër të takimeve të rreg-

ullta, pas atij që është mbajtur më herët, ku edhe janë diskutuar dhe janë marrë vesh për

disa tema për të cilat, siç ka thënë ai, kanë shprehur gatishmëri për bashkëpunim.

Universiteti i Prishtinës nuk preferohet shumë nga studentët e pakicave

PRISHTINË, 29 TETOR - Nga numri prej 845 vendeve të rezervuara për studentët nga komunitetet pakicë, për regjistrim këtë vit akademik në nivelin bachelor në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" janë regjistruar vetëm 106 studentë. Ndërsa për nivelin master, nga 269 vende, këtë nivel e kanë regjistruar vetëm 27 veta. Këto të dhëna i ka prezantuar për "Radion Evropa e Lirë" Esat Kelmendi, sekretar i Rektoratit të Universitetit të Prishtinës. Ai ka thënë se studentët nga komunitetet joshumicë kanë shfaqur interesim më të madh për ta studiuar mjekësinë dhe edukimin, ku provimet janë mbajtur në gjuhët përkatëse, atë serbe, boshnjake dhe turke. "Interesimi më i madh nga komunitetet joshumicë këtë vit, por edhe vitet paraprake, ka qenë kryesisht në Fakultetin e Edukimit, Fakultetin e Mjekësisë, Fakultetin Filozofik, pastaj vijnë këto të shkencave teknike, do të thotë arkitekturë, inxhinieri kompjuterike, juridik, ekonomik e tutje", ka thënë Kelmendi, duke shtuar se provimi pranues mbahet në gjuhët përkatëse të komunitetit, do të thotë, "komuniteti RAE edhe shkollimin e mesëm edhe fillor e kryen në gjuhën shqipe, ndërsa komuniteti boshnjak dhe turk,

në gjuhën amtare, prandaj edhe testi përpilohet në gjuhën e tyre amtare", ka theksuar ai.

Me qëllim të krijimit të lehtësive për regjistrimin e studimeve, kuota për pranimin e studentëve nga radhët e pakicave, nënvizoi ai, është më e ulët në krahasim me komunitetin shumicë. "Këto kategori me kuota të rezervuara kanë një lehtësi në raport me atë shumicë, sepse pragun e kalueshmërisë nuk e kanë 40 për qind, por e kanë 30 për qind dhe hyjnë në garë mes vete për vendet e rezervuara", ka deklaruar Kelmendi.

Marrë parasysh që numri më i madh i vendeve të rezervuara për komunitete pakicë mbetet i paplotësuar, vitet e kaluara ishte shënuar edhe fenomeni i tentativave nga studentët e komunitetit shqiptar që t'i zënë vendet e zbrazëta. Por, sipas sekretarit Kelmendi, këtë vit ky problem është evituar. "Jo, nuk ka pasur asnjë problem, asnjë tentativë. Të gjitha janë verifikuar nga përfaqësues të komunitetit joshumicë, janë verifikuar paraprakisht kandidatët të cilët kanë aplikuar se a i takojnë komunitetit përkatës, pastaj është bërë regjistrimi. Pranimi është bërë me kusht, derisa është kthyer përgjigjja e verifikimit", është shprehur Kelmendi.



Dukagjin Pupovci, drejtues i Qendrës për Arsim të Kosovës, vlerëson se ka disa arsye se pse studentët e pakicave nuk janë të interesuar të studiojnë në Universitetin e Prishtinës. Sipas tij, një ndër arsyet kryesore është se nuk e flasin gjuhën shqipe. "Unë mendoj se në shumë raste mund të jetë problem gjuha e studimit, pasi një numër i studentëve, në veçanti nga komuniteti boshnjak, nuk e flasin gjuhën shqipe në masën e duhur për të mundur të studiojnë në atë gjuhë. Po ashtu, ekzistojnë mundësi të cilat u

jepen pjesëtarëve të disa komuniteteve që të studiojnë në vendet tjera në gjuhën e tyre amtare. Këtu në radhë të parë e kam fjalën për komunitetin turk, ku mundësitë për të studiuar në Turqi janë jashtëzakonisht të mira", ka thënë Pupovci.

Kurse studentët nga komuniteti serb, sipas tij, zakonisht zgjedhin të studiojnë në Universitetin e Mitrovicës së Veriut. "Në radhë të parë në Kosovë ekziston mundësia që të studiohet në gjuhën serbe, ekziston Universiteti i Mitrovicës së Veriut ku, po supozoj, pjesa më e

madhe e komunitetit serb gravitojnë. I kemi aty edhe këto arsye politike pra, sepse po supozoj SE pjesëtarët e komunitetit në masë të madhe edhe hezitojnë të studiojnë në një institucion i cili është nën autoritetin e Republikës së Kosovës, prandaj edhe orientohen edhe më shumë kah Universiteti i Mitrovicës së Veriut", ka theksuar Pupovci. Përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në të gjitha institucionet e Kosovës u garantohet atyre me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera në fuqi.

Unifikimi i kurrikulave Kosovë - Shqipëri, mundësi e mirë

Prishtinë, 29 tetor (ER) - Ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, i shoqëruar nga ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Oemal Minxhozi, ka vizituar institucionin privat të arsimit fillor "Arsimi i Shqipërisë", shkollë e cila funksionon me kurrikula dhe tekste shkollorë të Shqipërisë. "Kam qëndruar në disa klasa dhe kam bashkëbiseduar me nxënësit. I kam porositur të jenë të përkushtuar në mësim dhe të kërkojnë më


shumë nga mësimdhënësit. Rinia jonë është pasuria më e madhe që kemi dhe kjo rini po na bën dhe duhet të na bëjë edhe më krenarë si shtet. I përgëzoja mësimdhënësit dhe nxënësit për punën dhe të arriturat në këtë shkollë dhe, po ashtu, edhe për faktin se nxënësit e kësaj shkolle kanë përfaqësuar Kosovën për herë të parë në Modelin e Parlamentit Evropian", ka thënë ministri Bytyqi. Ai ka shtuar se janë të rinjtë ata

që po i tregojnë Evropës se nuk dallojnë asgjë nga moshatarët e tyre në shtetet e zhvilluara. "Prandaj institucioneve u mbetet të krijojnë kushte të mira për arsimim dhe më shumë mundësi për ta", është shprehur Bytyqi. Edhe ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Oemal Minxhozi, ka theksuar se shkolla të tilla të Shqipërisë në Kosovë dhe anasjelltas janë një mundësi e mirë për t'i parë mundësitë e unifikimit të kurrikulave.



Kosova e kërkon mbështetjen e Gjermanisë për transformimin e FSK-së

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të hënën në takim shefin e stafit të Forcave të Armatosura të Gjermanisë, gjeneralin Eberhard Zorn. Duke e falënderuar shtetin gjerman për kontributin e gjithanshëm për shtetndërtimin e Kosovës, Haradinaj ka thënë se mbështetja e Gjermanisë është e domosdoshme edhe më tutje, në shumë procese të rëndësishme nëpër të cilat po kalon Kosova



gjerman në Park Inovativ dhe Trajnues.

Shefi i stafit të Forcave të Armatosura të Gjermanisë, gjenerali Eberhard Zorn, vlerësoi të arriturat në Kosovë në fushën e sigurisë dhe krijimin e një ambienti të qetë për të

gjithë qytetarët, duke konfirmuar mbështetjen e vazhdueshme të Gjermanisë për Kosovën.

Në shenjë falënderimi, kryeministri Haradinaj e nderoi gjeneralin Eberhard Zorn me medaljen e "Gjergj Kastriotit -

Skënderbeut". Në takim ishin të pranishëm edhe ministri i Forcës së Sigurisë, Rustem Berisha, ambasadori gjerman në Kosovë, Christian Heldt, si dhe komandanti i Forcave të Sigurisë së Kosovës, Rahman Rama.

EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 TETOR - "Kontributi i shtetit gjerman dhënë Kosovës në të gjitha etapat, e në veçanti në çështjen e sigurisë përmes trupave të KFOR-it gjerman, ka luajtur rol vendimtar për çlirim dhe tani për krijimin e stabilitetit dhe të ambientit të sigurt për qytetarët e vendit. Andaj, në emër të qeverisë dhe popullit të Kosovës falënderoj secilin ushtar gjerman që ka dhënë kontributin e tij duke shërbyer në misionin paqeruajtës në Kosovë", kështu ka thënë kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në takim me shefin e stafit të Forcave të Armatosura të Gjermanisë, gjeneralin Eberhard Zorn. Gjatë takimit kryeministri Haradinaj e ka njoftuar gjeneralin Zorn për prioritetet e Qeverisë, zhvillimet politike në

vend, forcimin e sundimit të rendit dhe ligjit, procesin e transformimit të FSK-së në ushtri, duke kërkuar nga shteti gjerman që edhe më tutje të jetë mbështetës i të gjitha proceseve të mëdha. Duke e falënderuar shtetin gjerman për kontributin e gjithanshëm për shtetndërtimin e Kosovës, kryeministri Haradinaj ka thënë se mbështetja e Gjermanisë është e domosdoshme edhe më tutje, në shumë procese të rëndësishme nëpër të cilat po kalon Kosova. "Marrëdhëniet bilaterale ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë janë në nivel të shkëlqyer që nga kohët më të vështira. Ndërsa tani jemi duke punuar që ky bashkëpunim të jetë i frytshëm edhe në zhvillimin ekonomik dhe fusha të tjera të interesit të përbashkët", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke marrë si shembull të mirë shndërrimin e kampit ushtarak

Ambasadori Kastrati i dorëzon letrat kredenciale te presidenti sloven

PRISHTINË, 29 TETOR - Ambasadori i Republikës së Kosovës në Slloveni, Avni Kastrati, në një ceremoni zyrtare të zhvilluar në Zyrën e Presidentit, ia dorëzoi letrat kredenciale presidentit të Republikës së Sllovenisë, Borut Pahor, duke u akredituar ambasador fuqiplotë i Kosovës

në Slloveni. Me këtë rast, presidenti Pahor i ka uruar mirëseardhje dhe suksese në Republikën e Sllovenisë ambasadorit Kastrati. Ndërkaq ambasadori Avni Kastrati e falënderoi presidentin Pahor për pritjen duke i përcjell përshëndetjet e përzemërta të presidentit të

Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi. Ambasadori Kastrati, gjithashtu, ka theksuar përkushtimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për avancimin e gjithanshëm të bashkëpunimit dhe të marrëdhënieve miqësore ndërmjet dy shteteve dhe dy popujve.



Bahtiri kërkon nga drejtorët që të realizohen të hyrat vetjake sipas parashikimeve

MITROVICË, 29 TETOR (ER) - Nën udhëheqjen e kryetarit të Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, dhe në prani të nënkryetarit Faruk Mujka, është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve, në të cilën janë shqyrtuar pikat e rendit të ditës të propozuara nga drejtorët e drejtorive komunale, të cilët ishin të pranishëm në takim. Fillimisht kryetari u njoftua nga drejtorët e drejtorive komunale për kompletimin e listave për menaxhimin e rreziqeve nga veprimtaritë përkatëse. Në takim u fol edhe për realizimin e të hyrave vetjake të komunës për nëntë muajt e këtij viti. U konstatua se inkasimi i të hyrave vetjake në krahasim me vitin e kaluar të periudhës së njëjtë nëntëmuajore kanë shënuar rritje prej 11.1

përqindësh, pasi është arkëtuar shuma 1,699,343,98 euro. Krahasuar me planin e paraparë për këtë periudhë të këtij viti të hyrat vetjake janë realizuar në shumën prej 92,4 përqindësh. Kryetari Bahtiri u tha drejtorëve se duhet të angazhohen maksimalisht në mënyrë që të hyrat e planifikuara të realizohen sipas parashikimeve, madje edhe të tejkalohen ato. Anëtarët e bordit në këtë mbledhje shqyrtuan edhe disa çështje me rëndësi për punën e drejtorive të administratës komunale. Kryetari Bahtiri edhe në këtë takim të Bordit të Drejtorëve ka kërkuar angazhim maksimal të inspektorëve komunalë dhe të gjithë faktorëve të tjerë për parandalimin dhe ndërprerjen e ndërtimeve pa leje.

Mbledhja e mbeturinave të vëllimshme

Sakupljanje obimnog otpada / Hacimli atık toplaması

1-7 Nëntor / Novembar / Kasım



Shërbimi bëhet vetëm dy herë në vit dhe është pa pagesë

Usluga je samo dva puta godisnje i bezplatno

Bu hizmet yılda iki defa düzenlenir ve hizmet ücreti yoktur

Sektori i Menaxhimit të Mbeturinave / Sektor za Upravljanje Otpadom / Atık Yönetimi Sektörü

Këtë javë nis mbledhja e mbeturinave të vëllimshme në Prizren

PRIZREN, 29 TETOR (ER) - Komuna e Prizrenit në javën e parë të muajit nëntor do ta fillojë aksionin e mbledhjes së mbeturinave të vëllimshme nga të gjitha amvisëritë. "Sektori i Menaxhimit të Mbeturinave në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike në javën e parë të muajit nëntor do ta fillojë aksionin e mbledhjes së mbeturinave të vëllimshme nga të gjitha amvisëritë. Aksioni do të reali-

zohet nga data 1 nëntor deri më 7 nëntor. Mbeturina të vëllimshme llogariten të gjitha gjësendet e vjetruara që nuk përdoren, duke përfshirë orëdi të vjetra shtëpiake, vitrina, set ulëse, tepihë, pajisje teknike etj", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Prizrenit. Ku dhe kur duhet t'i hidhni? "Mbledhja e mbeturinave të vëllimshme do të realizohet sipas orarit të mbledhjes së mbeturinave të rëndomtë.

Shtëpitë private këto mbeturina duhet t'i vendosin para dyerve, në ditën kur bëhet shërbimi për mbledhjen e mbeturinave në lagjen përkatëse. Ndërsa banimet kolektive duhet t'i vendosin ato në pikën publike më të afërt të grumbullimit të mbeturinave. Mbeturinat e vëllimshme nuk duhen të hidhen në çdo kohë! Ky shërbim është pa pagesë dhe bëhet dy herë në vit", është thënë në njoftimin e komunës.



Vizitë objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare

PEJË, 29 TETOR (ER) - Komuna e Pejës, në bashkëpunim me OSBE-në dhe Shkollën e Mesme të Arteve "Odhise Paskali" të Pejës, kanë organizuar një aktivitet gjysmëditor për 19 nxënës nga shkolla e artit për t'i vizituar objektet kryesore të trashëgimisë kulturore dhe

fetare të qytetit të Pejës. Gjatë vizitës nxënësit janë shoqëruar nga drejtori i shkollës, mësimit-hënësit dhe zyrtarët komunalë. Nxënësit i përdoren kamerat për t'i fotografuar objektet e vizituara, pra kjo do ta stimulojë interesin e nxënësve, frymëzimin dhe krijimtarinë më vonë

në vepra arti, gjatë orëve të tyre të rregullta mësimore, apo edhe të rezultojë më vonë me ndonjë ekspozitë të vogël të shfaqur në shkollë. Ky aktivitet i inkurajon nxënësit që ta shikojnë trashëgiminë kulturore dhe fetare si trashëgimi të përbashkët.

Në komunën e Malishevës shumica e projekteve në infrastrukturë janë në përfundim

MALISHEVË, 29 TETOR (ER) - Këshilli i Drejtorëve të Komunës së Malishevës ka mbajtur të hënën mbledhjen e rregullt në të cilën drejtorët e drejtorive komunale kanë raportuar për punët dhe aktivitetet e tyre gjatë javës së kaluar dhe planifikimet për këtë javë. Gjatë raportimeve të drejtorëve të drejtorive u tha se po vazhdohet me aktivitetet dhe punët e rregull-

ta për realizimin e planifikimeve vjetore nga secila drejtori, ndërsa edhe realizimi i projekteve kapitale është duke vazhduar sipas planifikimeve. Gjithashtu, në këtë mbledhje u bë me dije se është duke u vazhduar realizimi i projekteve në investimet kapitale, ku shumica dërrmuese prej tyre janë në përfundim e sipër, sidomos projektet në infrastrukturë.



Oda Amerikane: Ndryshimi i Ligjit për TVSh-në avancoon reformën fiskale

PRISHTINË, 29 TETOR (ER) - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka mirëpritur vendimin e Qeverisë për plotësim-ndryshimin e legjislacionit tatimor, e në veçanti të Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Sipas kësaj ode, ndryshimi i Ligjit për TVSh-në, i cili do ta mundësojë mbledhjen e brendshme të këtij tatimi, është përgjigje e Ministrisë së Financave ndaj kërkesave të sektorit privat dhe

asociacioneve të biznesit, si dhe avancim i mëtejme i reformës fiskale.

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë vlerëson se kjo masë, së bashku edhe me masat e tjera fiskale të implementuara gjatë këtij viti, si dhe gjatë viteve të fundit, pa dyshim se do ta bëjnë më atraktive ofertën e Kosovës për investitorët e jashtëm, por edhe për investitorët e brendshëm. "Investitorët amerikanë tashmë

shohin atraktivitet më të madh në tregun e Kosovës, e konfirmim i kësaj është edhe ardhja e brendeve amerikane në shtetin e Kosovës, proces ky i cili do të vazhdojë edhe në javët dhe muajt në vijim. Prania e brendeve amerikane do të reflektojë siguri edhe për kompanitë e tjera ndërkombëtare të cilat me vite kanë ngurruar t'i shtrijnë aktivitetet e tyre afariste në Kosovë. Reformat e vazh-



dueshme në mjedisin e të bërit biznes, të pasqyruara edhe në raporte të organizatave ndërkom-

bëtare si Banka Botërore dhe Fondacioni Heritage, janë rezultat i dialogut aktiv ndërmjet sektorit privat dhe publik në të kaluarën, ndërsa që rezultatet pozitive të mos mungojnë në këtë drejtim nevojitet konsideratë dhe angazhim më i madh për dialogun publiko-privat, veçanërisht për fuqizimin e sundimit të rendit dhe të ligjit", është thënë në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane të Kosovës.

Pyllëzohen 300 hektarë tokë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 TETOR - Agjencia Pyjore e Kosovës edhe në vjeshtën e këtij viti ka filluar realizimin e projektit të përvitshëm për pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura. Në kuadër të këtij projekti, i cili edhe sivjet është duke u financuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, gjegjësisht Agjencia Pyjore e Kosovës, do të pyllëzohet një sipërfaqe prej 300 hektarësh. Krahas kësaj, institucionet shtetërore angazhimin e tyre përmes projekteve të ndryshme për pyllëzimin e sipërfaqeve dhe ruajtjen e tyre do ta vazhdojnë çdo vit. Kështu është thënë të hënën në pyllëzimin e sipërfaqeve në fshatin Llashticë të Komunës së Gjilanit, ku për t'i parë nga afër punimet për realizimin e këtij projekti kanë marrë pjesë kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, zëvendësministri i MBPZHR-së, Mevludin Krasniqi, sekretari i Përgjithshëm i ministrisë, Kapllan Halimi, si dhe kryeshefi ekzekutiv i APK-së, Ahmet Zejnullahu.

Me këtë rast, kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka thënë se nevoja për një ambient të pastër dhe të pyllëzuar është e domosdoshme. "Kosova ka nevojë për ambient më të pastër. Kosova në raport me vendet e BE-së ka një situatë të mirë me pyjet. Po



ashtu, hedhja e mbeturinave është e papranueshme. Le të mundohen ta hedhin, madje jo gjithkund, mos të shkatërrohet ambienti. Ta ruajmë jetën tonë. Është kulturë e vendit tonë. Mbi 50 për qind duhet të arrijmë pyllëzim", ka thënë ai.

Ndërkaq zëvendësministri Mevludin Krasniqi ka thënë se ministria do të përkushtohet

për ruajtjen e ambientit pyjor si dhe për rritjen e sipërfaqeve të pyllëzuara nga viti në vit. "Me qëllim të përmirësimit kualitativ të pyjeve, këtë vit po pyllëzohen mbi 300 hektarë në tërë territorin e Republikës së Kosovës", ka thënë zëvendësministri Krasniqi.

Kryeshefi i APK-së, Ahmet Zejnullahu, ka treguar se pro-

jekti i pyllëzimeve në vend do të përfundojë në fund të muajit nëntor, ndërkaq planifikimet e kësaj agjencie për pyllëzim në vitin 2019 do të dyfishohen. "Planifikojmë që në vitin 2019 të pyllëzojmë një sipërfaqe prej 600 hektarësh", ka thënë kryeshefi Zejnullahu. Po ashtu, ai ka treguar se përmes projektit të FAO-s në pranverën e këtij

viti kanë pyllëzuar edhe një sipërfaqe prej 70 hektarësh. Ai ka treguar se vetëm në fshatin Llashticë në tre vjetët e fundit janë pyllëzuar rreth 40 hektarë, ndërsa gjatë këtij viti do të pyllëzohen dy hektarë. Edhe këtë vit fidanët për pyllëzimin e këtyre sipërfaqeve janë marrë nga fidanishtja pyjore që është pjesë e Agjencisë Pyjore të Kosovës.

Reçica takon të riatdhesuarit, përfitues të programit të vetëpunësimit

PRISHTINË, 29 TETOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka takuar të hënën disa qytetarë të riatdhesuar, të cilët janë përfitues të Programit të Vetëpunësimit, program ky i përbashkët i MPMS-së dhe UDNP-së, me mbështetje të Ministrisë së Punëve të Brendshme që po mbështet personat e riatdhesuar nëpërmjet kyçjes së tyre në masat aktive të tregut të punës. Përfituesve të riatdhesuar të cilët kanë hapur bizneset e tyre


iu ndanë të hënën disa pajisje të ndryshme, me qëllim të ofrimit të mbështetjes për punën në bizneset e tyre. Me këtë rast, ministri ndau edhe nga një certifikatë për të riatdhesuarit, me ç'rast uroi përfituesit dhe u dëshiroi suksese në bizneset e tyre.

E pranishme ishte edhe zëvendëspërfaqësuesja e përhershme e UNDP-së në Kosovë, Alessandra Roccasalvo. Ministri Reçica ka thënë se MPMS-ja me anë të këtij programi po synon të kontribuojë

për integrimin e personave të riatdhesuar në tregun e punës dhe t'u krijojë atyre lehtësira në të bërit biznes. Në kuadër të Programit të Vetëpunësimit, nga janari deri në tetor të këtij viti kanë përfituar 190 persona të riatdhesuar dhe 20 punëkërkuar të rregullt. Ndërkaq, po në të njëjtën periudhë, MPMS-ja, bashkë me UNDP-në, ka ndërmjetësuar në masa aktive të tregut të punës 693 punëkërkuar, prej tyre 333 të rregullt dhe 360 punëkërkuar të riatdhesuar.



Nëse ka interes, Hashim Thaçi mund t



Behxhet Sh. SHALA
- BAJGORA

Zgjedhjet e parakohshme nuk ndryshojnë asgjë: Vazhdoj të mendoj se në këtë kohë zgjedhjet e parakohshme nuk janë zgjidhje dhe nuk do të sjellin ndryshim cilësor në skenën politike të Kosovës. Edhe nëse do të kemi zgjedhje, do ta kemi një situatë ku: "zbret Hyseni për të na kërcyer Hasani...". E keqja e skenës politike në Kosovë është se nuk kemi opozitë e cila do të ishte alternativë e kësaj pozite si në aspektin e arritjes së një marrëveshjeje në interes të qytetarit, në veçanti për çështje të tjera që kanë interes për Kosovën e që aktualisht edhe e kanë sjellë një ngërç ku thuaja asgjë nuk funksionon dhe ku çdokush mund të bllokojë një proces apo edhe votimin e një ligji që ka interes të përgjithshëm, edhe për vetë opozitën. Pozita është si është, me vuajtje të Tantalit e siguroi 61 vota që po e mban në pushtet, kurse opozita, ndonëse e ka shumicën e votave shqiptare dhe elektorale, nuk po ka mundësi t'i sigurojë 61 vota dhe t'i provokojë zgjedhjet e parakohshme e që prijatë për këtë është LDK-ja sepse, sipas meje, me të drejtë beson se mund të dalë fituese në këto zgjedhje. Pas kësaj edhe LV-ja është e interesuar të shkojë në zgjedhje të parakohshme, më shumë për t'iu hakmarrë dhe

përfunduar nga loja dhe skena politike PSD-në, që tani po e konsideron më armik se edhe vetë PDK-në sesa që është e bindur se do ta marrë pushtetin. Të fillojmë nga LDK-ja:

1. LDK-ja, nëse zgjedhjet mbahen brenda gjashtë muajve, e nëse në ndërkohë nuk do të ketë ndryshime që e ndihmojnë dhe forcojnë pozitën (liberalizimi i vizave, përparim në formimin dhe dinamika më e shpejtë e transformimit të FSK-së, ndonjë investim të madh, rritja e njohjeve të Kosovës, anëtarësimi në Interpol etj.) i fiton zgjedhjet, por jo aq bindshëm sa të bëhet përcaktuese për formimin e institucioneve. Në rastin konkret nuk e besoj se do të bëjë koalicion parazgjedhor me LV-në sepse humbëse do të ndaheshin të dyja palët. Ndërkaq, pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve eventuale të parakohshme, të vetmin post që do ta kishte LDK-ja do të ishte posti i kryetarit të Kuvendit. Në pamundësi ta sigurojë shumicën përcaktuese, LDK-ja do të detyrohej t'ia lë postin e kryeministrit LV-së ose një subjekti tjetër politik i cili do të kishte kapacitet të mjaftueshëm shantazhues për formimin e Qeverisë. Madje nuk do të përjashtohej mundësia që Fatmir Limaj të ofrohej për postin e kryeministrit apo, nëse LDK-ja do të hynte në koalicion me AAK-në dhe PSD-në, atëherë të gjendej një kryeministër konsensual dhe i cili nuk do të ishte nga radhët e LDK-së. Posti i kryeministrit do të jetë i kushtëzuar me kapacitetet shantazhuese dhe, në këtë rast LDK-ja do ta kishte fitoren e Pirros dhe gjithmonë do të ishte duke shkuar drejt greminës. LDK-ja ka krizë të lider-

shipit për shkak të gjendjes shëndetësore të kryetarit aktual Isa Mustafës.

Isa Mustafës nuk i shkon fjala si më parë sepse LDK-ja është shndërruar në oktapod politik, me shumë pretendent për postin e kryetarit. E kemi Lutfi Hazirin që është kandidat permanent për kryetar të LDK-së, i cili nuk është i përgatitur për maratonë garuese sepse mbushet frymë atëherë kur duhet ta kalojë cakun. Më shumë e lodhin partitë e tjera që i premtojnë se do ta përkrahin në këtë luftë për marrje të kreut të LDK-së, se vetë anëtarësia e kësaj partie e që pastaj bëhen me Isa Mustafën. Sesa është në out Luta në politikën moderne e tregon kushtëzimi që i bën LV-së e cila, sipas Lutës, duhet ta pranojë "filozofinë politike" të Ibrahim Rugovës e që pastaj të bisedojnë për një koalicion të mundshëm. Madje, për ta dëshmuar këtë, LV-ja duhet të dërgojë lule apo kurorë të varri i Ibrahim Rugovës! Çfarë ideje e papjekur dhe e papeshuar politikisht aq më parë që askush më nuk po merret më me Ibrahim Rugovën sikur që, edhe vetë eksponentë të LDK-së, emrin e Rugovës e përdorin apo, më mirë ta themi, e keqpërdorin vetëm kur t'u vijë veza te bytha apo kur e kanë ngushtë. E tash merreni me mend sikur LV-ja ta kushtëzojë koalicionin me LDK-në me të pranuarit e rolit dhe kontributit të Xhingis Kanit në lëvizjen politike të shqiptarëve. Ose, nëse LV-ja e kushtëzoi këtë koalicion që dikush nga pretendentët për kryetar të LDK-së të angazhohet për flladitjen e koç... të Albin Kurtit. Marrëzira janë kushtëzimet nëse keni interes dhe qëllim të përbashkët. Kushtëzimet janë vetëm mënyrë për ta refuzuar

koalicionin dhe bashkëpunimin. Isa Mustafa ka bërë përpjekje që ta lë pas vetes Avdullah Hotin - komandant Dullën, vazhdues i politikës së Isës dhe ta bëjë të parin e LDK-së si edhe kryeministër. Këtë kurrë nuk do ta pranojnë Agim Veliu, Haki Rugova, Vjosa Osmani, Lutfi Haziri, Lumir Abdixhiku apo Driton Selmanaj sikur edhe dikush tjetër nga diaspora. Nga një pozicion krejtësisht neutral mendoj se vetëm dy persona sot i plotësojnë kushtet për kryetar të LDK-së, Kujtim Shala dhe Avdullah Hoti. Që të dy kanë kapacitet politik, plus Dulla edhe njohuri në fushën e ekonomisë, mirëpo kanë mungesë të karizmës si dhe të arrogancës e që është e domosdoshme për rrethanat e Kosovës e që i kanë disa prej kandidatëve që i përmenda më lart. Mund të më hidhërohet Ismet Beqiri sepse e kam mik dhe jam dhëndër i bastionit të Ismetit (Kodra e Trimave), mirëpo ai nuk mund të bëhet i pari i LDK-së.

2. LV-ja është ndarë dhe nga ajo u larguan 12 deputetë e që nuk është punë e vogël. Tash militantët e Kaçushës po e qërojnë edhe pushtetin lokal nga LV-ja duke bërë koalicion me të gjithë ata që mund t'i ndihmojnë për qërimin e hesapeve me LV-në. Armiqësia e LV-së përballë PSD-së vetëm sa do ta dëmtojë LV-në në të ardhmen dhe do ta forcojë Kaçushën me PSD-në. LV-ja ende po funksionon me një bosht të vetëm udhëheqës dhe vendimmarrës, rreth Albinit të përbashkuar, kurse pjesa që e përkrah Albinin e që ka ardhur nga partitë e tjera, disi është plakur dhe ka mungesë të theksuar të potencës politike. LV-ja e organizoi një protestë të madhe paqësore, mirëpo

përfundoi me kaq. LV-ja dhe asnjë subjekt tjetër politik nuk ka kapacitet të organizojë një masë kritike të protestuesve permanentë e që do t'i lëviznin gjërat. Kjo është e vetmja mundësi për ndryshime. Ndonëse ka bërë përpjekje ta bëjë një retushim të së kaluarës puro kombëtare, me bashkimin kombëtar si lajtmotiv, LV-ja nuk i ka bindur ndërkombëtarët ta përkrahin në përpjekje që ta udhëheqë qeverinë. Dhe pa ta nuk mund të bëjë asgjë, madje as të gjejë partnerë që do të qeverisin me këtë parti. LV-ja nuk mund të qeverisë me LDK-në pa Albinin kryeministër e që për rrethanat momentale del të jetë mision i pamundur. LV-ja ka potencial të ndahet mirë në zgjedhjet e parakohshme eventuale nëse harron vija të kuqe, si përballë PSD-së ashtu edhe subjekteve të tjera politike. Në të kundërtën, do të hyjë në një proces riciklimi i cili nuk do të ketë ndikime në proceset politike në Kosovë, e sidomos në rajon.

3. PDK-ja ka probleme në disa komuna sikur që është Drenasi dhe Skenderaj, Prizreni, por edhe në ndonjë komunë tjetër e që do të plasarit më vonë. Në komuna kryesore nuk ka kandidatë që bëjnë vota apo që e rrisin numrin e votuesve. Kur e them këtë mendoj për Gjilanin, Mitrovicën, Pejë, Prishtinën, vende ku ka edhe më së shumti votues. Deri më tani, për aq sa po duket, nuk ka ndryshime premtuese as në qytetet e tjera ku në lojë janë lojtarët, jo që i sjellin vota të reja PDK-së, por ia humbin edhe ato që i ka. Meqë i njoh rrethanat në Llap, PDK-ja në dy zgjedhjet e fundit nuk ka pasur kandidatë të hairit që do ta përparonin partinë, por ka

Juniku, probleme me energji elektrike

JUNIK, 29 TETOR (ER) - Komuna e Junikut është e shqetësuar me gjendjen jashtëzakonisht të rëndë me furnizim me energji elektrike. "Kjo gjendje nuk është e tanishme, por është një vazhdimësi e cila po ndodh tash e një kohë të gjatë në komunën tonë. Edhe përkundër premtimeve për përmirësim nga ana e KEDS-it, gjendja vazhdon të mbetet e rëndë. Juniku i ka ofruar bashkëpunim KEDS-it për çdo aktivitet të tyre deri më tani, por nga sot, si pasojë e gjendjes jashtëzakonisht të rëndë energjetike, injorimit të kërke-

save të qytetarëve, mungesës së vullnetit dhe gatishmërisë për bashkëpunim me komunën për ta zgjidhur situatën e rëndë e cila ka përfshirë Komunën e Junikut me rrethinë, ndërpret çdo lloj bashkëpunimi deri në përmirësimin e gjendjes", është thënë në njoftimin e Komunës së Junikut. Komuna ka njoftuar se për veprimet e tjera nuk mban asnjë përgjegjësi, duke pasur parasysh faktin se qytetarët e Komunës së Junikut janë ndër paguesit më të rregullt të energjisë në Kosovë, ku pagesa e faturave shkon mbi 90 për qind.



'i provokojë zgjedhjet e parakohshme!

pasur kandidatë që askush nuk i ka dashur, madje janë të urryer në këtë mes. E kuptoj nëse në një qytet pësoni humbje nga ndonjë kandidat i fortë, por të pësoni humbje për dy palë zgjedhje nga një analfabet politik siç është Agim Bahtiri në Mitrovicë, është e paimagjinueshme! Apo, të llogarisni në vota nga kandidatë apo udhëheqës që janë në kundërshtim me ligjin, kjo është vdekjeprurëse për një subjekt politik në shtigje afatgjata. Kadri Veseli nuk ka qenë sinjerisht i pranuar si kryetar konsensual i PDK-së, sidomos nga pjesa intelektuale e cila ka qenë dhe ka mbetur në vartësi të Hashim Thaçit dhe Kadri Veseli e kanë pranuar si kryetar, ose nga këshillat e vet Thaçit, mbase kanë pasur frikë nga personaliteti i Veselit të cilin nuk e kanë njohur sa duhet dhe, besoj, si llaskuçë që janë për pushtet dhe rreth pushtetit, një pjesë e tyre e kanë pranuar në këto baza. Kadri Veseli, për mendimin tim, e ka marrë udhëheqjen e partisë në kohën më të keqe të mundshme duke mos e forcuar liderhipin apo duke e ndarë këtë liderhip me Hashim Thaçin, pa vullnetin e vet. Kam shpresuar dhe besuar se Kadri Veseli do t'i bëjë reformat e duhura në PDK sikur që do ta reformojë edhe skenën politike të Kosovës. Këtë bindje nuk e kam më dhe as besimin. Hashim Thaçi ia ka lënë fushën e minuar brenda PDK-së dhe, kur të dojë dhe kur ka nevojë, mund t'i aktivizojë ato mina politike. PDK-ja ka nevojë për reformë të thellë dhe këtë mund ta bëjë vetëm duke kaluar në opozitë. PDK-ja ka nevojë për transfuzion dhe për gjak të ri politik kurse këta, shumë që po qarkullojnë për vite të tëra, herë si deputetë,

herë si ministra apo poste të tjera, e kanë gjakun e mpiksuar dhe potencën politike e kanë në nivelin e një eunuhi nga haremi i një sulltani. Lideri i vërtetë merr rreziqe dhe përgjegjësi, në të kundërtën vetëm mund ta luajë rolin e liderit. Kadri Veseli ka shumë kundërshtarë brenda PDK-së që respektin dhe "lojalitetin" e kanë nga frika se mbesin pa pushtet dhe nga interesi. Përjashtuar pak raste, këshilltarët politikë të Kadri Veselit nuk i plotësojnë kushtet për një shkollë fillore politike. Para se të vendosë çka do të bëjë me PDK-në, Kadri Veseli duhet të vendosë çka do të bëjë me veten e vet dhe me Hashim Thaçin. Vetëm pas kësaj, mund të shohë me qartësi drejt ardhmërisë.

4. AAK-ja nuk e ka problem liderin dhe liderhipin. E ka Ramushin pa të cilin nuk ka të gjallë, i cili punon me një kondicion të çuditshëm, e lë përshtypjen se nuk e njeh politikën sikur këta të tjerët, por që në momentet vendimtare Ramushi nuk largohet as për një milimetër nga interesi kombëtar. Jam i sigurt se nëse e kërkon puna, Ramushi përsëri do të radhitet në vijën e parë të frontit dhe për këtë as që kam edhe mëdyshjen më të vogël. Mund të mos e ketë diturinë politike të Çerçillit, por e ka patriotizmin 100 %, i cili ia mbulon mangësitë eventuale në politikë. Në Kosovë edhe nuk bëhet politikë e profilit aq të lartë e që kërkohen dituri të shkëlqyera politike. Edhe pas zgjedhjeve eventuale të parakohshme, AAK-ja do të ndahet mirë dhe do të jetë përcaktuese për formimin e institucioneve dhe nuk do të jetë befasi nëse Ramushi përsëri mund të jetë lojtar i fuqishëm për kryemi-

nistër.

5. Nisma, sikur LV-ja dhe AAK-ja, nuk ka problem me udhëheqje dhe udhëheqës. Fatmir Limaj nuk kontestohet nga askush dhe përkrahet nga të gjithë shkaku se e ka krijuar një mjedis që varet nga ai, në çdo aspekt. Fatmir Limaj në zgjedhjet eventuale të parakohshme do të ofrohet si kandidat për kryeministër, jo në bazë të koncepteve politike që do të sillnin risi, por në bazë të asaj se është i vetmi që do ta luftonte Hashim Thaçin. Edhe diletantët në mjekësi e dinë se kafshimi i gjarprit helmues shërohet me një serum nga helmi i gjarprit tjetër helmues. Në këtë kartë luan edhe Fatmir Limaj. Pastaj, llogarit se mund të jetë i pranueshëm nga të tjerët e që unë dyshoj. Nisma besoj se e kalon pragun zgjedhor, por nuk pasurohet shumë me vota.

6. PSD-ja besoj se e kalon pragun zgjedhor, e sidomos nëse hyn në koalicion parazgjedhor me ndonjë subjekt tjetër. Por, edhe nëse shkon e vetme në zgjedhje, besoj se e kalon pragun zgjedhor, përkundër disa sondazheve që e lënë jashtë Kuvendit. LV-ja po punon në favor të PSD-së.

7. AKR-ja është kooperativë parapolitike që duhet të shkojë në ricycle been (shportën e mbeturinave). Koalicioni parazgjedhor e fuqizoi këtë parti private dhe parti të zadrugës.

Diçka për titullin: Hashim Thaçi është president i Kosovës, lëkurën e të cilit po e kërkojnë të gjithë, por Gjykata Kushtetuese e Kosovës (ndonëse përbërja e fundit e kësaj Gjykate është e kriminalizuar dhe profesionalisht e hendikepuar) e mbron nga çdo sulm. Kot e kanë të bëjnë llogari për largimin e tij me

anë të votave sepse kjo është e pamundur. Kushtetuta e Kosovës, shprehimisht e thotë se kur një president mund të shkarkohet dhe Hashim Thaçi, si sinonim i dinakërisë, nuk shkelë dot në dërrasë të kalbur siç e bënë Fatmir Sejdiu dhe Behgjet Pacolli, që u shkarkuan, por i gëzojnë të gjitha privilegjet e mundshme, sikur të ishin trashëgimtarët e brezit të parë të Ismail Qemalit. Po të vendosnin edhe 120 deputetë, nuk do ta shkarkonin Hashim Thaçin. Për metoda si mund të shkarkohet Thaçi, një herë tjetër. Po flitet për zgjedhje eventuale të parakohshme për të cilat thashë se nuk do të prodhojnë asnjë ndryshim. Opozita nuk mund të provokojë këto zgjedhje edhe nëse e ka përkrahjen e plotë të presidentit në ardhje, Zafir Berishës. Pozita nuk është e interesuar për zgjedhje të parakohshme andaj i vetmi person që mund t'i provokojë këto zgjedhje është Hashim Thaçi, presidenti aktual i Kosovës. Ai mund ta shpërndajë Kuvendin e Kosovës duke e arsyetuar me mosfunksionim të Kuvendit, bllokim të bisedimeve me Serbinë, mosliberalizim të vizave dhe mungesë të bashkëpunimit midis pozitës dhe opozitës për çështje me interes vital për Kosovën. Dhe arsye të tjera që ka me bollëk dhe nga të cilat dështimi e heq përgjegjësinë ndonëse, sipas mendimit tim, e që nuk do të thotë se e kam të drejtë, Hashim Thaçi është përgjegjësi numër një për gjendjen e krijuar, së bashku me Edita Tahirin, Behgjet Pacollin, Enver Hoxhaj dhe Bekim Çollakun. Jo që dua t'i amnistojë, por përgjegjësia e Isa Mustafës, Fatmir Sejdiut, Skender Hysenit, Mimoza

Ahmetajt, Vlora Çitakut dhe tash e Dhurata Hoxhës është minimale sepse, në mungesë të fuqisë politike, vetëm kanë zbatuar urdhra të shefave.

Në bazë të vlerësimit, Hashim Thaçi mund t'i provokojë zgjedhjet e parakohshme me të cilat amnistion veten, por edhe të tjerët për mosliberalizim të vizave, dështim të bisedimeve me Serbinë, dështim të integriteteve në mekanizmat ndërkombëtarë dhe përkrahjen e zvogëluar ndërkombëtare siç ua tha edhe i dërguari nga ShBA-ja, z. Palmer. Me zgjedhjet e parakohshme eventuale, e që nuk besoj se do të ndodhin, Hashim Thaçi do ta fajësojë opozitën se e ka penguar bashkimin e Luginës së Preshevës me Kosovën me të cilët Thaçi haptazi po luan koçë. Lojtar i fortë është Hashimi, sidomos kur luan me ekipe të rangut të dytë apo edhe ata që kanë tru politik e që i ka blerë me ndonjë post apo i kërcënon me ndonjë sanksion meqë aparatun për këtë e ka në dispozicion online. Ta shohim nëse Gjykata Kushtetuese i kthen përgjigje që i duhet Hashimit për kompletimin e KQZ-së, pas së cilës, do ta kemi një pasqyrë të qartë nëse do të kemi zgjedhje të parakohshme deri në fund të vitit 2018 apo ky proces do të ndodhë më vonë. Në mes të dy mundësive që të shkohet në zgjedhje të parakohshme me vendim të presidentit Thaçi apo pas një marrëveshjeje politike midis pozitës dhe opozitës, jam për mundësinë e dytë, por se ka pak gjasa të ndodhë. Po presim, ka filluar numërimi nga prapthi!

Urime Barcelonë për shuplakën (pesëshen e dhënë Realit)!

Fillojnë punimet për ndërtimin e pesë rrugëve në Kaçanik

Kaçanik, 29 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, dhe nënkryetari Ylber Bajra, janë takuar të hënën me drejtorët e drejtorive të kësaj komune, në kuadër të aktiviteteve dhe projektet javore komunale. Në këtë takim përfaqësuesi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike ka bërë me dije se projektet kapitale janë në vllugun e punimeve. Ai ka theksuar se kanë filluar punimet për ndërtimin e pesë rrugëve në kuadër të projektit "Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Kaçanikut" në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës. Në kuadër këtij projekti do të rregullohen rrugët në fshatin Elezaj: "Iliria", "Pishtarët e

Lirisë" dhe "Shqiponja", ndërsa në fshatin Stagovë rruga "Man - Dashi" si dhe rruga "Prushi" në fshatin Kaçanik i Vjetër. Ky projekt do të realizohet në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Komunën e Kaçanikut për vitin 2018, ndërsa në tërësi do të kushtojë 100 mijë e 162 euro e 24 centë. Gjatë javës Drejtoria e Shërbimeve Publike do t'i fillojnë punimet edhe në kuadër të projektit "Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale", ku pritet të fillojnë punimet tek Zyra e vendit në Kaçanik të Vjetër, trotuari në Provoli, rruga "Martirët" në fshatin Stagovë, si dhe rehabilitimi i rrugës në lagjen "Rakoc".



(Procesi gjyqësor i Prizrenit më 1946 sipas dokumenteve të gjykatave ish-jugosllave. Para trupit gjykues dolën 34 patriotë të cilëve gjyqi ua shqiptoi dënimet: gjashtë veta i dënoi me pushkatim, të tjerët me vite të shumta burg) /8/

Tahir Deda, bashkëpunëtori më i ngushtë i Halim Spahisë



Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

(Sqarim: Shkrimi në vazhdim botohet pa i bërë redakturë gjuhësore pasi është i shkruar si në dokumentet origjinale)

Organi kryesuar për punën destruktive të pandehurit Halim ka qenë i pandehuri Tahir Deda. Bashkëpunimi në mes të tyre dhe miqësia intime e tyre, fillon ç'prej kohës së luftës d.m.th. që prej tri vjetve. Në konditat e dyshimit ç'prej çlirimit Kosovës dhe të Metohisë, dhe si anmiq të përbetuar të barazisë të vllaznimit e të bashkimit të popujve jugosllav dhe lirisë së tyne Demokratike tue ndryshue taktikën e veprimtarisë të disa t'armatës Jugosllave tue përdor mënyrat e rafinueme dhe dinake hynë në pushtetin populler dhe në Komandat ushtarake tue përfutue lirin e funksionin, të cilat i kanë pasua me qëllim të bëjnë luftë po kundra atyre pushtetave dhe kundra rregullimit të shtetit. Halim Spahija si kryetar i Këshillit Populler të Rrethit, Tahir Deda, Avdyll Regjepi, Hasan Rustemi, Rifat Krasniqi e te tje. Si nënpunsa shtetnore të Jugosllavisë së re, gjithë ashtu Ahmet Durguti si intendant i vendit, Basri Salkoviqi si N/ Komandant i Vendit Ferizaj, të gjithë së bashku janë vumun vazhdimisht e kanë vazhdua ushtrimin e tyre kundra pushtetit ku punojnë që t'a zhdukun për të cilin qëllim janë dhe kryetar Ballistë si Uk Sadiku, kapiten Riza Aliu, profesor Ymer Berisha e të tj. me të cilët kanë bashkpunue. Të pandehurit më të tillë bandita janë lidhun, janë bashk-fjalue tue dhanë instrukciojone njeni tjetrit që t'unisojnë punën e njerës palë me tjetrën palë, tu ju mbështetën instrukciojonevet të maruna prej agentive të reaksionit huaj tu ju bind këtyne konditave kanë vazhdua punën tue kërkua intervenimin e tyre tue pritur urdhrat e tyre, kur dhe ç'far lufte me bamun; kur armata Jugosllave ka ndjekun bandat nëpër male banditët, si Tahir Deda, Rifat Krasniqi janë vumun në dispozicion dhe kanë përhapun rrjetin e tyre destruktive kundra pushtetit popullar në të cilin bashkin pjesë. Kanë propagandua, kanë shijua e tj. gjana tue mbetur të pa diktuar. Të pa diktuar për këtë arsye: pse as kush nuk ka dyshue që ata të cilit kanë qenë si dishmitar të viktimave të terrorit fashist, të cilit kanë qenë dishmitara e luftës vllavrasje

që ka bamë okupatori, të cilit kanë qenë koshijent për viktimat që popujt e Jugosllavisë kanë dhanun për lirin e tyre; as kush nuk ka mendue që ata kanë me pasun guximin me punua ne një organizatë kundra frutave e të drejtave t'Ushtresë Nacional-Çlirimtar, por mjerisht ata prapë kanë punue. Këte ata vet e pohojnë. Ky bashkëpunim i tyre shihet kjar-tazi në Pohimet e të pandehurit Tahir Deda, i cili deklaroi: që kamë punua verbërisht si mbas udhëzimeve të Halim Spahisë, të cilin e kamë ditur që asht agent i të huajvet dhe si i till ka dhanun instruksione me anën e Hasan Remës gjithë ashtu agentit e të huejvet ka marun dhe vumun në zbatim të gjitha instruksionet e duhuna për formimin e Komitetit, për propagandën antipopullore, për mbledhjen e informativ, me anën e të cilave agentat e të huaj kanë përfutua për propagandën e tyre shpifse kundra shtetit tonë e të tjera. Tahir Deda pohon që ka formua Komitetin Qëndruar, i cili ka pas për qëllim me udhëheqë të gjitha Komitetet, gjithashtu pohon që ky Komitet ka udhëheqë e drejtua me antarët e ngushtë të tij: Fehim Ibrahim, Avdyll Regjepin, Hasan Rustemin, Maliq Balin dhe Basri Salkoviqin. I pandehuni Tahir Deda pohon dhe këto që ka ngarkua Fehim Ibrahim të bijën në marveshtje me Komitetin Ballist në Prizren, i cili këtë gjë e ka krye me sukses dhe njikohsisht me e riorganizua e me i bashkue me Komitetin që Tahir ka formua, dhe Maliq Balis i ka ngarkua që të lidhet me Komitetin e rrethit të Rahovecit ta riorganizoj dhe të nënshtrohet tue marun prej tij drejtimit e duhuna, gjë që e ka ba, ka marun lidhje me ta ose me këto Komitete dhe ka dërgua listat e kërkueve prej Komitetit të Qendrës mbi të denuemit e kriminelave të luftës. I pandehuni Tahir Deda pranon edhe këte që ka dhanë parullat themeltare të propagandës antipopullore mbi padrejtësinat që i bahen popullit Shqiptar në Jugosllavin e re, për



mos njoftjone të drejtave Kombtare, dhe që Shqiptara, munden me fitue të drejtat e tyre të plota vetëm tue punue me kësi lloj Komitetesh që Tahir ka formua e të tjera. Krejt kjo propagandë ka pasun për qëllim me formue urrejten ndaj rregullimit të ri të Jugosllavisë Demokratike Federative, me mundun në këtë mënyrë me përfutue këta të fundit në një luft kundra Jugosllavis Demokratike Federative. Gjith ashtu polion që ka dhanë direktiva për me formue Komitetet në Kosovë këtyne personavet: Basri Salkoviqit për Ferizaj, Kaqanik dhe Gilan, Ramadan Kajtazit për Prishtinë dhe Murat Ademit për Podujevë. Tahir Deda si mbas pohimit të tij dhe në bazë të listavet të zanuna (të gjetuna) tek Avdyll Regjepi ka grumbullua informata mbi kriminelët e luftës e denuem e anmiqt e popullit e të viktimave Ballistë të luftës së Drenicës Fruer - Mars 1945 i cili mendonte me i dërgua për jashtë shtetit e me këto lista të paraqesin e të tregojnë se janë viktimat të terroit mbi popullin Shqiptar. Ai pohon edhe se ka bashkpunue me kryetarët e bandave Ballistë gjatë luftës së Drenicës edhe mbas këtyre luftimeve. Si mbas pohimit të tij nga njena anë ka mbajtur lidhje dhe ka bashkpunue me bandat Ballistë dhe nga ana tjetër ka futun njerëz në pushtetin populler që ta angazhojnë nënpunsit si p.sh. Avdyll Regjepin nënpunës i Financavet në Prizren, Hasan Rustemin nënpunsi i Këshillit Populler të Prizrenit e të tjerët. Të gjitha këto i ka bamun me qëllim me minue e me shprijunue pushtetin populler tonin. Prap ai pohon që vet personalisht ka formue Komitetin e Suharekës dhe ka dhanë instruksionet e duhuna për sa i takon detyrës së tij. Si mbas pohimeve të tij nga njena anë ka mbajtur lidhje dhe ka bashkpunue me bandat Ballistë dhe nga ana tjetër ka futun njerëz në pushtetin populler që të angazhojnë nëpunës si psh.

Avdyll Rexhepin nëpunës i Këshillit Populler të Prizrenit, Hasan Rustemin nëpunës i Këshillit Populler të Prizrenit e të tjerët. Të gjitha këto i ka bamun me qëllim me minue e me shprijunue pushtetin populler tonin. Prapë ai pohon që vet personalisht ka formua Komitetin e Suharekës dhe ka dhanë instruksionet e duhura për sa i takon detyrës së tij. Pra, Tahir Deda asht organizatori kryesuar i Komiteti në fjalë dhe i besueshmi personal i të pandehurit Halim Spahiut.

Fehim Ibrahim, Avdyll Regjepi, Hasan Rustemi e Maliq Balija akuzoheshin për këto veprime:

Të pandehurit Fehim Ibrahim, Avdyll Regjepi, Hasan Rustemi e Maliq Balija kanë pohua ne procesvebalet e maruna prej hetuesit, që kanë marë pjesë ne Komitetin e Tahir Deds që kanë zbatua pikërisht detyrat e dhanuna prej organizatës. Ata në pohimin e tyre kanë vërtetua krejt çka u tha ma sipër prej të pandehurit Tahir Deda. Por gjanë ma kryesore që të naltpërmenduni (me përjashtim të Hasan Rustemit) i largohen dhe nuk donë me tregua dhe qi asht lufta e armatosur kundra rregullimit të ri të shtetit, që ka qenë qëllimi kryesuar i krejt kësaj organizatës. Për këtë gjë tregon i pandehuni Hasan Rustemi, por fakti ma i mirë dhe ma i sigurt asht letra e direktivave "Instruksionet Kryesore", e cila asht gjeten tek i pandehuni Avdyll Regjepi e Basri Salkoviqi. Hasan Rustemi në procesverbalin e tij të 13 korrikut dhe të 2 Shtatorit thotë që i pandehuni Tahir kur ka dhanun instruksionet Basri Salkoviqit ka theksua, që bandave në mal duhet me u dhanë udhëzime që mos bajnë asnjë aksion dhe mos të vrasin pse, "kur të vijnë urdhri (këtu thotë prej Komitetit Qëndruar) të gjitha rugët kryesore duhet të bllokohen, në mënyrë qi asnjë partizan mos të ketë mundësi me hikun

kur të niset lufta". Gjithë ashtu në këtë rast i ka theksua Basriut duhet që të punojmë që të organizohemi për një luftë tarmatosun kundra këtij pushteti, në këtë rast ka thannun edhe për një kryengritje të përgjithshme e të tjera. Nasnji mënyrë tjetër nuk mundet me u shpjegua ndryshe e tanë organizata, por vetëm si Komitet tradhtar, i cili ka pas për qëllim një kryengritje t'armatosun kundra rregullimit të ri të Jugosllavisë Demokratike Federative, kështu në "instruksionet kryesore" flitet shumë kjar-tas "ç'asnji lëvizje nuk mundet me u ba pa Komitetit Qëndruar, gjithunji duhet me qenë në lidhje me lëvizjen t'on të jashtme. Gjithë ashtu lëvizja e jone e jashtme nuk do të punojë asgjë, vetë do të rrinë në pritje. Lajmet e informatat duhet të drejtohen Komitetit të Rrethit, dhe në se njerëzit e caktuam nuk munden me i krye këto detyra, këto do të kryhen prej anës së femnavet të besueshme. Të gjitha forcat që ndodhen përjashta duhet të kenë përgjegjësat e tyre (Komandat), të cilët kanë me ba organizimin e ushtresë në dhjetëshe, në toga e në kompani, në këtë mënyrë Qendra do të veprojë si Komandë. Përjashtohen rastet e jashtëzakonshme që mund të ngajnë togave ose kompanive, në rast se nuk mundë të presin urdhrin ose shejat me u tërhjek munden me veprua si mbas rastit e mendimit të tyre, p.sh. nëse rrethohen prej armikut ose ndonjë rast tjetër. Në se asht e mundun duhet pa tjetër të lajmërojnë urgenjesisht dhe në qoft se mbas një dite ose dy asht e detyrueshme që të lajmërohet Komanda. Gjithashtu gjanat e nevojshme si ushqim e të tjera duhet të kërkohen nga Komanda mbarse në mënyrë që çdo ndihmë që vjen të vehet në dijeni Komandës. Siç shihet, fjala asht te Komandat, Komandantat, Kompanit, togat e skuadrat si qendra dhe ky asht Komiteti Qëndruar si Komandë e vetme e tjera. Kjo asht gjëja kryesore qi i pandehuni Tahir Deda bashkë me të pandehurit të tjerë kanë heshtur mbi pikë dhe nuk kanë tregua të vërtetën, kjo paraqet një hapë të rëndë përmbi krejt organizatën. Kur e gjithë kjo të lidhet me pohimin e të pandehurve për krijimin e Komiteteve në të gjitha anët dhe nënshttrimin e tyre të domosdoshëm nën Komitetin Qëndruar, i cili vepron si Komandë superiore atëherë shihet sheshazi që qëllimi e organizatës ka qenë për një luftë t'armatosun d.m.th. me anën e forcës të përmbysnin pushtetin ekzistues të rregullimit të ri të Jugosllavisë Demokratike Federative, dhe mbasi të kenë bë këtë, këto Komitete të mermin në dorë qeverinë. (Vijon)



Djathtisti Jair Bolsonaro, fiton zgjedhjet presidenciale në Brazil

BRAZILI, 29 TETOR - Ligjvënësi i së djathtës ekstreme Jair Bolsonaro ka fituar zgjedhjet presidenciale në Brazil, një zhvillim që ka shtuar frikën për një rikthim pas në çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut dhe fjalën e lirë.

Jair Bolsonaro i Partisë Social Liberale fitoi rreth 56 për qind të votave në balotazhin e së dielës ndërsa kundërshtari i tij i krahut të majtë Fernando Haddad i Partisë së Punëtorëve rreth 44 për qind të tyre. "Qeveria jonë do të formohet nga ata njerëz të cilët kanë të njëjtin qëllim me ata që më mbështesin mua, me synimin

për ta shndërruar Brazilin në një komb të madh, të lirë e të begatë. Dua t'u garantoj se do të punojmë ditë e natë për këtë", tha Jair Bolsonaro, presidenti i zgjedhur Brazilian.

Fitorja e tij është një tregues i refuzimit që votuesit i bënë administratave të majta që e kanë qeverisur Brazilin për pjesën më të madhe të 15 viteve të fundit. Vendi me ekonominë më të madhe në Amerikën Latine ndodhet në recesion që prej vitit 2014. Institucionet politike janë tronditur nga një skandal korrupsioni i nivelit të lartë dhe treguesit e krimit e të vrasjeve

janë rritur.

Jair Bolsonaro bëri një fushatë për ndryshim, duke e përshkruar veten si një kandidat i ligjit dhe rendit, i cili do t'i japë policisë më shumë liri për të goditur krimin.

Por shumë brazilianë janë të shqetësuar për admirimin e tij të shprehur ndaj diktaturës ushtarake të viteve 1964-1985 dhe për komentet fyese ndaj homoseksualëve, pakicave racore dhe grave.

Bolsonaro është një ish-ushtarak, i cili për shkak të retorikës së tij të ekstremit të djathtë, premtimeve dhe një personaliteti të vendosur është



cilësuar si "Trump-i tropikal". Zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë Sarah Huckabee Sanders tha se presidenti

Donald Trump e telefonoi të dielën në mbrëmje për ta uruar presidentin e zgjedhur të Brazilit Jair Bolsonaro.

Angela Merkel nuk do të kandidojë më për kancelare

Angela Merkel konfirmoi të hënën se nuk do të kërkojë rizgjedhje në krye të partisë dhe si kancelare, duke shënuar kështu fillimin e fundit të mbizotërimit të saj 13-vjeçar në politikën evropiane. Ajo ka drejtuar partinë që nga viti 2000 dhe është kancelare e Gjermanisë që nga viti 2005. Sekretarja e përgjithshme e CDU-së, Annegret Kramp-Karrenbauer, është favoritja e Merkelit për ta pasuar atë

BERLIN, 29 TETOR - Angela Merkel tha të hënën se nuk do të kandidojë më për postin e kancelares në vitin 2021 në fund të mandatit aktual, pasi një sërë krizash politike dhe rënia e thellë e mbështetjes për partinë e saj në dy votime rajonale tronditën koalicionin e saj të brishtë. Kancelarja Merkel kishte informuar më parë partinë e saj Bashkimi Kristian-Demokrat (CDU) se do të tërhiqej nga posti i kryetares së partisë në kongresin e saj në dhjetor për t'i hapur rrugën një udhëheqjeje të re.

Angela Merkel konfirmoi të hënën se nuk do të kërkojë rizgjedhje në krye të partisë dhe si kancelare, duke shënuar kështu fillimin e fundit të mbizotërimit të saj 13-vjeçar në politikën evropiane. "Së pari, në Kongresin e CDU-së në dhjetor në Hamburg, nuk do të kandidoj për

kreun e CDU-së. Së dyti, ky mandat i katërt është i fundit për mua si kancelare e Gjermanisë. Në zgjedhjet federale të vitit 2021, nuk do të kandidoj për postin e kancelarit, as për Bundestagun, dhe për hir të protokollit nuk do të kërkoj më poste politike", tha ajo. "Sot është koha për të filluar një kapitull të ri", u tha ajo gazetarëve në selinë e partisë.

Më parë Merkel kishte lënë të kuptohej se kishte ndër mend të kërkonte një mandat tjetër dyvjeçar, por duket se veproi me shpejtësi në përgjigje të presionit për udhëheqje të re. Merkel ka drejtuar partinë që nga viti 2000 dhe është kancelare e Gjermanisë që nga viti 2005. "Me këtë vendim, po përpieqem të jap një kontribut që i jep mundësi qeverisë gjermane, të përqendrohet tek përpjekjet për qeverisje të mirë, diçka që njerëzit e kërkojnë



me të drejtë", tha Merkel. Paraardhësi i Merkelit, Gerhard Schroeder, dha dorëheqje si udhëheqës i socialdemokratëve të së majtës së qendrës në vitin 2004, ndërsa qeveria e tij po përballlej me sfida por e mbajti postin e kancelarit. Për vite me radhë Merkel ka këmbëngulur se kancelari duhet të jetë edhe kryetar partie.

Aktualisht Merkel qeveris

Gjermaninë me një "koalicion të madh" të partive më të mëdha të vendit: CDU, Bashkimi Kristian-Social dhe socialdemokratët. Mandati i saj i katërt filloi në mars por qeveria e saj ka pasur debate të ashpra të brendshme.

Zhvillimet e të hënës vijnë pasi CDU-ja doli e para, por me humbje mbështetjeje në zgjedhjet në shtetin perëndimor Hessen të dielën, gara e dytë zgjedhore ku

pësoi rënie brenda dy javësh për aleancën konservatore të Merkelit. Tërheqja nga posti i kryetares së partisë do t'i jepte mundësi një personi tjetër nga radhët e CDU-së që të krijojë një profil të vetin para zgjedhjeve të ardhshme kombëtare në vitin 2021. Sekretarja e përgjithshme e CDU-së, Annegret Kramp-Karrenbauer, është favoritja e Merkelit për ta pasuar atë.

Rrëzohet avioni me 189 udhëtarë në Indonezi

XHAKARTË, 29 TETOR - Një aeroplan i kompanisë Lion Air me 189 udhëtarë dhe ekuipazh në bord u rrëzua në det 13 minuta pas nisjes nga Xhakarta, thanë zyrtarët indonezianë.

Zhytësit që u dërguan në vendin e ngjarjes arritën të nxjerrin pjesë nga trupat e viktimitave ndërsa një zëdhënës postoi në Twitter fotografi, ku dukeshin sende të ndryshme si një telefon celular, libra, çanta dhe pjesë të trupit të avionit të mbledhur nga anijet e kërkim-

shpëtimit. Ata thanë se midis udhëtarëve ishin një i mitur dhe dy foshnje.

Agjencia indoneziane e kërkim-shpëtimit është në kërkim të trupit të avionit që u rrëzua në veri të ishullit Java. Një zyrtar i agjencisë tha se nuk ka të mbijetuar.

Aeroplani u rrëzua në ujëra me thellësi 30 deri në 35 metra. Fluturimi JT610 nga Xhakarta duhej të përfundonte në qytetin Pangkal Pinang në ishujt Bangka Belitung.

Ende nuk dihen shkaqet e rrëzimit të tij.

Aksidenti është i pari që përfshin një Boeing 737 MAX, një avion i ripërtërirë, i shitur gjerësisht dhe me shpenzime më të vogla të karburanteve.

Prodhuesi i aeroplanit shkroi në twitter se ishte në dijeni të një aksidenti dhe po monitoronte nga afër situatën.

Zyrtarët në Indonezi thanë se të 189 njerëzit në bordin e aeroplanit që u rrëzua në det, "sipas të gjitha gjasave kanë vdekur".



E jashtëzakonshme

Princesha japoneze martohet me një njeri të thjeshtë

Princesha e Japonisë, 28-vjeçarja Ayako, është martuar me të dashurin e saj 32-vjeçar Kei Moriya, një nëpunës në një kompani anijesh. Martesa me një njeri të thjeshtë e detyron princeshën që të heqë dorë përfundimisht nga pozicioni i saj dhe luksi. Ceremonia u zhvillua



në kompleksin e shenjtë "Meiju Jingu" në Tokion qendrore dhe përfshiu shkëmbimin e unazave dhe pije japoneze.

FOTO E DITES



Gjethet e vjeshtës së një peme shihen në një park në qytetin verior të Francës, Scrignac. /AFP/

E rrallë

Dita e të vdekurve në Mexico City

Kryeqyteti meksikan në prag të "ditës së të vdekurve" mban një paradë në kujtim të emigrantëve që humbën jetën në kufirin mes Meksikës dhe ShBA-së. "Dita e të vdekurve" është një traditë prehispanike, në të cilën familjet kujtojnë të vdekurit dhe festojnë vazhdimësinë e jetës. 1 nëntori iu rezervohet fëmijëve që kthehen nga jeta e pëртеjme, ndërsa 2 nëntori të rriturve.



Festimet e "ditës së të vdekurve" në Meksikë konsiderohen një trashëgimi kulturore nga UNESCO, e gjatë këtyre ditëve turistët e huaj janë të shumtë.




DASHI

Dita do të nisë me nervozizëm dhe tension. Do të rregullohet gjithçka gjatë pasdites sepse do të jeni më të qetë.



DEMI

Një ditë e ndarë në dy pjesë, nga njëra anë dashuria si mendim fiks, më pas impenjimet familjare që nuk ju lënë të qetë derisa t'i mbyllni.



BINJAKËT

Nëse jeni në udhëtim dhe larg rutinës së përditshme, gjërat do të shkojnë më së miri në raportin në çift. Dialogu nuk do të mungojë.



GAFORRJA

Në ekuilibër perfekt dashuria dhe puna janë gjithmonë në sintoni me njëra-tjetrën gjatë ditës së sotme. Do të jeni në humor të mirë sot.



LUANI

Edhe pse janë ditë të qeta, puna është në plan të parë për ju. Kur të tjerët pushojnë, ju jeni tepër të ngarkuar me atë që duhet të mbaroni.



VIRGJËRESHA

Nuk ka nevojë për fjalë sot për t'u treguar personave të afërt se sa shumë t'i doni. Gjestet tuaja do të prekin këdo që do të jetë i pranishëm.



PESHORJA

Edhe pse paraditja do të shkojë mirë dhe qetë, pasdite do të keni situata të caktuara që do t'ju prishin humorin dhe do të reagoni keq.



AKREPI

Ka shumë nga ju që po mendojnë të dalin të jetojnë me vete. Kjo ditë do të jetë e mbarë në mjaft projekte të reja që keni ndërmarrë.



SHIGJETARI

Përveçse keni fituar shumë këtë periudhë, po aq keni shpenzuar. Në përgjithësi jeni armiq të lekur dhe nuk dini ta ruani atë.



BRICJAPI

Sot është një ditë e bukur dhe mjaft produktive për të gjithë ju që jeni të lidhur me kauza sociale.



UJORI

Nuk jeni shumë të qetë sot për shkak të ngarkesës së madhe që keni në punë. Doni të mbyllni çdo gjë në kohë për t'u nisur në një udhëtim.



PESHQIT

Edhe pse keni shumë punë këto ditë, jeni shumë të kënaqur dhe të përbushur me veten, kështu që nuk do të lodheni fare.

BARSOLETA E DITËS



Komandanti i thotë një polici:
- E sheh atë me pallto të zezë, përcille dhe shkoi prapa si hije!
- Nëse nuk ka diell, si të veprojmë, shoku komandant?



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

"ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

"JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennessey, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

"NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

"SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

"VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

Kelly Rowland mohon ta ketë zbardhur lëkurën



Kelly Rowland përmes "Instagram"-it u është përgjigjur thashethemeve se ajo ka zbardhur lëkurën. Thashethemet nisën kur ajo postoi disa fotografi në "Instagram" nga një xhirim bërë kohën e fundit. "Unë sapo arrita në LA dhe pashë që shumë njerëz janë si: 'oh Zot, ajo e zbardh lëkurën e saj'. Tani

kurrë nuk u përgjigjem pyetjeve të tilla si kjo, sepse mendoj se është budallallëk ose madje të bëj ndonjë koment për këtë. Unë nuk jam ajo që e zbardh lëkurën time, as nuk dua ta bëj atë. Pra, mos thoni gjëra të kota si kjo. Unë jam çokollatë, çokollatë përgjithmonë. Krenare që jam e tillë", ka thënë Rowland.



Rita Ora i kthehet vetvetes

Rita Ora është bërë sërish vetvetja, pas kostumit si Post Malone disa ditë më parë. Këngëtarja 27-vjeçare është fotografuar e veshur në të zeza me flokët e saj bionde pasi doli nga një klub privat të shtunën në Londër të Anglisë. Një natë më parë Rita

befasoi turmën në KISS Haunted House Party duke u veshur si Post Malone për performancën e saj. Më pas, Rita ishte e pranishme në Stricly Come Dancing, versioni britanik i Dancing With The Stars, për ta kënduar këngën 'Let You Love Me'.

Cardi B në formë vetëm tre muaj pas lindjes

Cardi B ka performuar në skenën e Mala Luna Music Festival në stadiumin Nelson Wolff në San Antonio në Teksas. Reperja tregoi trupin e saj të tonifikuar e veshur me një kostum të zi. Tre muaj pas lindjes së vajzës Kulture Kiari, format e 26-vjeçares dukeshin mahnitëse. Cardi B zgjodhi një paruke bionde platini për performancën e saj.



49-vjeçarja Jennifer Lopez tregon muskujt



Duket e pabesueshme, por Jennifer Lopez është plot 49 vjeçe. Ylli është fotografuar në Kaliforni dhe duket më në formë se kurrë, pavarësisht prej viteve. 49-vjeçarja kishte veshur një bluzë të

verdhë të shkurtër, e cila i nxirrte në pah muskujt e barkut. Këtë bluzë ajo e kishte kombinuar me një palë streçe me ngjyra. J. LO është parë duke shkëmbyer puthje me të dashurin e saj, Alex Rodriguez.

Autor: Gazmend Morina - BENI	AKTORI AMERIKAN NË FOTO 1	KUNDËRSHTAR NË MENDIM, KUNDËRVËNËS	DËSHIRA E SËMURË PËR TË PËRDORUR OPIUMIN (med.)	IRNOSEMI (bised.)	VEPËR E JOSIP RELËS	▼	SHPEND ME QAFË TË GJATË (sh.shq.) TITAN	ZANORE	FUTBOLLISTI ANGLEZ DARIUS	EPOKA ERE	LUFTËTARI KRYESOR ME DEMA NË SPANJË, I CILI E MBYT DËMIN E PLAGOSUR	BABAI	1						
EMËRORE, RASA E PARË E LAKIMIT (gram.)	◇									MIMOZA AHMETI PEMË E VENDEVE TË NGROHTA (sh.shq.)									
GAZ LUFTE QË SHKAKTON PLAGË NË LËKURË DHE HELMON ORGANIZMIN (shq.)	◇							KRYEMURG KRYETAR I NJË EPARKIE ORTODOKSE											
GRUAJA QË PISPILLOHET PËR SË TEPËRM; LOZONJARE (fr.)	◇						PIKTORI YNË VALLA (shq.) OTRANTO, BARI												
TINGULLIMITIMI (muz.)	◇																		KËNGËTARJA ME FAMË BOTËRORE MORISËT
ROKERI I NJOHUR KRAVITZ (shqip.)	◇						RILINDËSI YNË JERONIM	POEMA E VOGËL QË JEP NJË NGJARJE LLOJ KARR-OCE KUAJSH											
VENDI KU LIDHEN ESHTRAT	◇			DANTE ALIGIERI				BASHKËTINGËLLORE ACTIVE TRAINING EDUCATION		PJESË E PORTIT DETAR									
STANDARDS TRANSPORT. ZIMBABWE	◇			ZOG I EGËR GRABITQAR BASKETBOLLISTI YNË EDMOND						EPOKË (shq.) KLUB FUTBOLLI GREK				METODË STUDIMI	TRISKA, KUPONI	MUZIKA E SHTHURUR	QË KA KARAKTERIN E NJË MITI TRAJNERI ITALIAN MARÇELO		
BASHKËTINGËLLORE	◇	TENISTI I NJOHUR SAFIN DHËNIA E NJË ÇMIMI TË LARTË						DY BASHKËTINGËLLORE MJET PËR RRËSHQITJE PËR FËMIJË ME RROTA			AKTORJA AMERIKANE PORTMAN (shqip.) BASHKËTINGËLLORE								
KËNGËTARJA SHQIPTARE MARKU	◇									LLOJ LËNDE PLASËSE KAMËS; I PASUR; I									
DY ZANORE	◇		KËNGËTARJA ... ZARI BËRJE MË I RI				ZHANËR I MUZIKËS LINSANDO (shk.)				PIJE E NGROHTË ORIENTALE (shq.) DAFINË								
SHENJA NGA PREKJA E DIÇKAJE	◇					RESTORANT, KAFE OSE BAR-BUFE (bised.) DEM						FUTBOLLISTI CANA SHKRONJA XXIV							
EPOKA ERE	"R" para dy "I" FEMËR E ZGJEDHUR				HISTORIANI ROMAK LUKRECI FUTBOLLISTI HOLANDEZ RAFAEL ... DER VART				HUMANISTI BIÇIKEMI (shq.) VIGAN, KOLOS									EVERTON BIMË BARISHTORE ME TË CILËN BËHET PILAFI	
METËR; INDIUM FUTBOLLISTI BERBATOV (MAN. UTD.)			QË KA HUMBUR NJOMËSINË, QË Ë ËSHTË FISHKUR TEFIK OSMANI									ISH FUTBOLLISTI I NJOHUR BRAZILIAN AKTORJA E NJOHUR BASIGNER							SHKOMBËTARIZIMI
→							AZOT, IRIDIUM SHKATËRRIMI, RRËNIMI					KALJARI, ATALANTA HAITI			TOKA E BUKËS MURG I VETMUAR				
KËNGËTARI BRITANIK WEBBE					HAPËSIRË E MADHE UJI AKTORJA AMERIKANE NË FOTO 1					PRODUKT I ZJARRIT KËNGËTARI FRANÇESK		FUTBOLLISTI YNË ZABËRGJA EMRI I KOMANDANTIT LEGJENDAR TË UÇK-së							
2					PJESËTAR I EKUIPAZHIT TË NJË ANIJEJE	◇					SMIRA, RESA QYTET I LASHTË NË ILIRI								
	ERMELINDA MEKSI	◇						SHEGË KËNGËTARI HOXHA				DEPARTMENT EDUCATION TRAINING LLOJ VEGLE MUZIKORE							MOLDE
	SUPER MODELJA KATE (shqip.)	◇							MËDYSHJA RESHAT ARBANA										ZANORE LLOJ PESHKU
	MARRJA E TIPAREVE TË PARAARDHËSVE TANË	◇																	DY BASHKËTINGËLLORE NJËSIA E KOHËS
	MJET SHPËRTHYES	◇								OTO REHAGEL AZEM SYLA		AKTORJA E NJOHUR SPELLING DY BASHKËTINGËLLORE							
	AKTORJA HOLLIVUDIANE TURMAN	◇							RRËNJËS; KUNDREJT ARDHËS ZANORE										KORNIZË RUANDA
	FSHATI NË TË CILIN GJENDET AEROPORTI I TIRANËS	◇										MJET I THJESHTË LUNDIMI (shq.)							

Kungulli, ja përfitimet e tij përveç "Halloween"-it

Kungulli është perime shumë e mirë e vjeshtës, por në periudhën e Hallouinit shndërrohet në një 'super star' të vërtetë.

Nëse kemi rënë pre' e insistimeve të fëmijëve, apo kuriozitetit nëse ia dalim të gërryjmë një kungull për ta bërë abazhur të frikshëm për natën e Vitit të ri Kelt, do të kemi në dispozicion shumë tul, të gjithin për ta shfrytëzuar.

Tulin e kungullit mund ta përdorim për të bërë supra, apo për antipastë të stinës, pse jo edhe për të mbushur makaronat.

Kungulli mund të përdoret edhe si kozmetikë natyrale, në avantazh të lëkurës sonë.

Përfitimet e ngjyrës portokalli – Me ngjyrën e tij të gëzueshme, ky vegjetal, sjell humor të mirë në tavolinë.

Kungulli është shumë i pasur me beta karoten dhe flavonoidë, të nevojshëm për të luftuar plakjen e qelizave.

Gjithashtu është i pasur me fibra, ndaj rregullon aparatën gastro-intestinal, mbron sistemin imunitar dhe zhvillon një aksion antioksidant.

Farat e tij janë të pasura me vitaminë E dhe janë të nevojshme për të eliminuar shqetësimet në

aaratin urinar, sidomos në funksionimin sa më mirë të prostatës.

Përmbajnë edhe sasi të triptofanit, substancë që ndihmon në prodhimin e serotoninës, e dobishme kundër pagjumsisë dhe depresionit.

Për të shijuar përfitimet e farave të kungullit, mjafton t'i piqni në furrë dhe t'ia shtoni sallatës apo gotës së kosit që do konsumoni. Sasia e rekomanduar për konsum është 10 gramë në ditë.

Cilësitë – Kungulli, përveç beta karotenit dhe fibrave, ka një përmbajtje të lartë të vitaminave A dhe C, kriprave minerale dhe Omega Tre, yndyrnat e dobishme, të cilat ndihmojnë në uljen e kolesterolit.

Ka edhe veti antioksiduese, përmirëson lëkurën, ndihmon në forcimin e thonjeve dhe flokëve, ndihmon zemrën, lufton infeksionet, ul pagjumsinë dhe stresin.

Është e vlefshme edhe në regjimet hiperkalorike, pasi sjell vetëm 18 kalori për 100 gramë produkt. Kjo është e mundur, duke qenë se përmban shumë ujë: deri në 94,5%.

Karbohidratet nuk kalojnë 3,5%, ndërkohë që proteinat, shumë të pakta, janë vetëm 1,1%.



Yndyrnat mungojnë. Pra, kungulli ka aftësi të mira diuretike, ndaj ndihmonë organizmin në luftën ndaj celulitit.

Shija e tij e ëmbël ndihmon të shmangim ëmbëlsirat kur i dëshirojmë, por jemi në dietë dhe nuk mund t'i konsumojmë.

Vlen i gjithi, nuk hidhet asgjë nga kungulli – Jo të gjithë e dinë se lëkura e kungullit mund të përdoret: Në disa receta të kuzhinës italiane kungulli mund të gatuhet i gjithi, bashkë me lëkurën.

Në të gjenden shumë cilësi ushqyese, me aftësi antibiotike dhe antifunge.

Edhe lulet e kungullit janë të ngrënshme: Mund të konsumohen të si omltë me vezë, apo të skuqura thjesht.

Për bukuri – Tuli mund të përdoret edhe si maskë bukurie e bërë vetë.

Mjafton ta shtypësh, apo të përdorësh tulin që ke përfutur nga centrifugimi i blender-it.

Përzihet në një enë bashkë me

kos dhe mjaltë dhe përftohet një pastë e butë për t'u aplikuar në lëkurë dhe duhet mbajtur për 20 minuta.

Kungulli ngadalëson plakjen e lëkurës dhe ka efekt ushqyes, sidomos tek lëkura e thatë, dhe cilësi pastruese në lëkurën e yndyrshme.

Falë beta karotenit, tuli i kungullit, si për ta ngrënë, si në kozmetikë, është i vlefshëm edhe për ngjyrën e lëkurës, apo për të shmangur djegien e saj para ekspozimit në diell. (*gazeta-Shqip.com*)

5 produkte që shkatërrojnë shëndetin tuaj nëse e teproni

Çdo gjë e tepërt është e dëmshme! Këtë të gjithë e dimë, por shpesh herë përpiqemi ta anashkalojmë, duke mos i menduar pasojat që mund të kenë në shëndetin tonë.

Më poshtë po u tregojmë disa prej produkteve, të cilat dëmtojnë shëndetin tonë nëse përdoren në sasi të mëdha. Asnjëherë nuk duhet abuzuar me konsumimin e disa lloj produkteve, pasi problemet në shëndet do t'i shohim pas disa kohësh.

Çaji

Përdorimi i çajit në sasi të mëdha mund të krijojë probleme me veshkat. Ndaj rekomandohet që mos konsumohen më shumë se 6 filxhanë çaj në ditë, sepse në të kundërt mund të kemi efekte të padëshiruara.

Turshitë

Me siguri se një nga sallatat e preferuara gjatë dimrit janë turshitë, por acidi i tyre mund të

dëmtojë shtresën mbrojtëse të dhëmbëve tuaj. Rekomandohet që të mos konsumohen në sasi të mëdha edhe për shkak të përmbajtjes së lartë të kripës.

Pasta e dhëmbëve

Në fillim të viteve '90, në kutitë e pastave të dhëmbëve shkruhej: "Mos e gëlltisni dhe mos përdorni më shumë se madhësia e një bizeleje". Gëlltitja e pastës së dhëmbëve mund të krijojë probleme me stomakun. Veç kësaj, nëse gëlltisni sasi të mëdha problemet mund të jenë edhe më serioze. Madje mund të çojë deri në vdekje.

Peshku ton

Shumë njerëz e dinë se konsumimi i tepërt i peshkut ton mund të jetë i rrezikshëm, por pak prej tyre e dinë se cilat janë problemet që shkakton.

Disa lloj të peshkut ton përmbajnë sasi të mëdha mercuri, i cili është i dëmshëm për njerëzit, por



sidomos për fëmijët.

Pijet me gaz

Pijet me gaz dëmtojnë shëndetin, sidomos nëse konsumohen rreg-

ullisht. Përdorimi i shpeshtë i tyre sjell probleme të shumta shëndetësore, për shkak të pranisë së sheqerit në këtë pije.

Ato grumbullojnë yndyrë rreth organeve jetësore si mëlçia,

veshkat, stomaku dhe aparati tretës. Kjo bën që të shtohet rreziku për t'u prekur nga diabeti i tipit 2 dhe sëmundjet inflamatore.

(*gazeta-Shqip.com*)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BOURNEMOUTH - NORWICH

4+

BROMLEY - BRAINTREE

GG3+

CLUB BRUGGE - OOSTENDE

1

Ndryshon Flamurtari, tash i mjafton barazimi ndaj Dritës

Sot në kryeqytet zhvillohet përballja në mes të Flamurtarit dhe Dritës nga Gjilani, në kuadër të xhiros së trembëdhjetë në elitën e futbollit. Pavarësisht prej fitores në ndeshjen e parë në Gjilan, tash Flamurtari e pranon se do të ishte i kënaqur edhe me një barazim. "Për ne çdo rezultat tjetër përveç humbjes do të ishte një fitore e madhe, pasi do ta ruanim pozitën në të cilën jemi", ka thënë Arsim Thaqi, trajner i Flamurtarit

**EPOKA E RE****Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 29 TETOR - KF Flamurtari në xhiron e dytë të këtij kampionati në IPKO Superligën e Kosovës kishte tejkaluar parashikimet duke e mposhtur kampionen aktuale, Dritën në Gjilan, me rezultat 1-3. Por, tash synimet e kësaj skuadre janë më të vogla dhe një barazim do të ishte i mjaftueshëm nga ndeshja që e zhvillon në kryeqytet ndaj Dritës. Këtë e ka konfirmuar të hënën për "Epokën e re" trajneri Arsim Thaqi, i cili e pranon se skuadra e tij po ka probleme për shkak të mungesave. "Koha ka qenë e shkurt për ta përgatitur ekipin për ndeshjen ndaj Dritës, por sido që të jetë, ky është kampionati me ndeshje intensive. Problem për ne janë mungesat që na kanë kushtuar edhe në disa ndeshje të tjera, por e njëjta do të jetë edhe ndaj Dritës. Për ne çdo rezultat tjetër përveç humbjes do të ishte një fitore e madhe,

pasi do ta ruanim pozitën në të cilën jemi", ka thënë Thaqi. Mungesa për kuqezinjtë në ndeshjen ndaj Dritës do të jenë Neziri dhe Zeqiri, kurse Shillova vështirë se do të paraqitet, pasi ende nuk është maksimalisht i gatshëm për ndeshje. "Përveç portierit Neziri, mungon edhe mesfushori Zeqiri që në ndeshjet e para ka qenë titullar, kurse Alban Shillova ende nuk është i gatshëm qind për qind për shkak të lëndimit që ka pësuar ndaj Ballkanit, por do të jetë në tetëmbëdhjetëshë", ka deklaruar Thaqi.

Ndërsa Drita synon maksimumin nga kjo ndeshje. Këtë e ka konfirmuar sulmuesi Përparim Livoreka, i cili e ka vlerësuar skuadrën kuqezi kundërshtare shumë të fortë. "Na pret një ndeshje e fortë ndaj Flamurtarit, pasi ka ekip cilësor dhe jorastësisht është në pjesën e sipërme të tabelës. Ne udhëtojmë për të fituar për fitore dhe do të tregojmë në këtë ndeshje për punën që kemi bërë gjatë javës. E mira është se në

këtë ndeshje nuk kemi asnjë mungesë", ka thënë Livoreka për gazetë. "Drita dalëngadalë po arrin ta aplikojë lojën që i ka munguar në fillim. Trajneri Shpëtim Duro është duke bërë një punë të mirë dhe kemi ndryshuar dhe shumë shpejt do të jemi në pjesën e lartë të tabelës ku i ka edhe synimet", ka deklaruar Livoreka, i cili është ndër lojtarët me përvojë jo vetëm në skuadrën e dritës, por në futbollin e Kosovës. Sot (e martë) zhvillohet edhe ndeshja tjetër në mes të Lirisë dhe Ferizajt, kurse katër ndeshje të tjera zhvillohen të mërkurën.

IPKO Superliga
Të martën takohen:
12:30 Flamurtari - Drita
12:30 Liria - Ferizaj

Të mërkurën takohen:
12:30 Prishtina - Trepça '89
12:30 Feronikeli - Drenica
12:30 Llapi - Ballkani
12:30 Gjilani - KEK-u

SHKURT

U17 e Kosovës e mposhtën Zvicrën

Përfaqësuesja e Kosovës U-17 ka shënuar fitore të rëndësishme përballë Zvicrës me rezultat 1-0, në kuadër të Grupit 5 për kualifikimet e Evropianit 2019 që po mbahen në Qipro. Pas ndeshjes së parë në të cilën janë mundur nga Skocia 1-2, kësaj radhe të përzgjedhurit e trajnerit Besnik Kollari, krahas lojës së mirë, kanë arritur t'i arkëtojnë edhe pikët e plota. Golin e fitores për "Dardanët" e rinj e ka shënuar Valon Zumberi në minutën e 63-të. Në ndeshjen e fundit Kosova U17 do të luajë përballë Qipros, kombëtare e cila në ndeshjen e parë kishte humbur 0-3 nga Zvicra, derisa sot ka barazuar 1-1 me Skocinë.

Presidenti Moustafa uron Federatën e Hendbollit të Kosovës

Presidenti i Federatës Ndërkombëtare të Hendbollit (IHF), Hassan Moustafa, i ka dërguar të hënën një letër presidentit të Federatës së Hendbollit të Kosovës, Eugen Saraçini. Me këtë rast, Moustafa e ka uruar Saraçinin për organizimin e "IHF Trophy" dhe suksesin e përfaqësuesve U18 e U20 të Kosovës. "I nderuar president, më lejoni t'ju përcjell një urim të dyfishtë. Së pari për organizimin e shkëlqyeshëm për të cilin të gjithë pjesëmarrësit janë shprehur të lumtur. Së dyti, ju përgëzoj në emër të IHF-së për titujt e përfaqësuesve tuaja, duke ju dëshiruar fat në të ardhmen", thuhet në letrën e presidentit Moustafa.

Ronaldo e synon "Topin e Artë", ja përgjigjja e Ronaldos

Ylli i Juventusit, Cristiano Ronaldo, i cili shënoi 44 gola për Real Madridin në sezonin e kaluar dhe ka 7 gola me "Zonjën e Vjetër" në këtë sezon, ka bërë me dije se po synon ta fitojë "Topin e Artë" për vitin e tretë radhazi. "Unë mendoj se e meritoj atë edhe këtë vit. Po ëndërroj ta fitoj 'Topin e Artë' për herë të gjashtë, duke e kaluar, në këtë rast, Lionel Messin", ka thënë Ronaldo.

Atletja ruse pezullohet 4 vjet

Sportistja ruse e hedhjes së çekiçit, Tatyana Kachegina, është pezulluar me 4 vjet nga të gjitha veprimtaritë, pasi ka rezultuar pozitive me disa substanca të ndaluara, lajm që është konfirmuar nga "Associated Press". Pas një kontrolli antidoping, në urinën e sportistes janë gjetur një "koktej" lëndësh të ndaluara si steroidë anabolizues (turinabol dhe stanozolol), melidonium dhe hormoni i rritjes GHRP-2. Ky është pezullimi i parë që vjen për atletikën ruse që kur WADA vendosi ta njohë laboratorin e saj në Moskë dhe IAAF hoqi pezullimin trevjeçar të atletikës ruse.

Dorëhiqet Severin Elezaj

KLINË, 29 TETOR - Severin Elezaj nuk është më trajner i Dukagjinit nga Klina pasi ka dhënë dorëheqje nga kjo detyrë pas humbjes nga Istogu (3-1). "Pas disa viteve si trajner i Klubit

Dukagjini, Elezaj largohet nga klubi ynë. Kryesia e klubit, presidenti dhe drejtori, bashkë me stafin e shtabit teknik, e futbollistët me të cilët ka punuar gjatë këtyre viteve, e falënderojnë

për kontributin dhe punën e tij. Gjatë kësaj kohe sa ishte në krye të klubit ai e dërgoi dy herë radhazi në barazh për Superligë, ku edhe treguan angazhim dhe karakter të pashoq. Në këtë

sezon 'Profa' e drejtoi klubin tonë në njëmbëdhjetë javët e para e ku klubi ynë gjendet në pozitën e katërt me 21 pikë", thuhet në njof-timin e skuadrës së Dukagjinit.



Mavraj: Kampionatin grek e pengojnë shumë gjëra jashtë futbollit

THESSALONIKI, 29 TETOR - Arisi i Mërgim Mavrajt dhe Migjen Bashës u mposht nga AEK-u i Athinës me rezultat 4-0. Në prononcimin pas ndeshjes, mbrojtësi i kombëtares shqiptare, Mavraj, u shpreh i zhgënjyer për këtë humbje që, sipas tij, ishte e pamerituar. Sipas 32-vjeçarit, kampionatin grek e pengojnë shumë gjëra jashtë futbollit. Mavraj fajësoi gjyqtarin për humbjen ndaj AEK-ut. "Në dy pjesë ndahet kjo ndeshje. Besoj se në pjesën e parë, shumicën e rasteve dhe qarkullimit të topit e kemi pasur ne. Kemi pasur ndeshjen në kontroll. Kemi pësuar një gol shumë pa fat. Top i devijuar, aty ishim pak naiv te goli i parë. Besoj se treguam karakter. Skuadrat e tjera të vogla kur e pësojnë një gol të tillë në minutat e para, humbin vetëbesimin dhe shpresën, kurse ne u përgjigjëm shumë mirë në mënyrën e lojës dhe pastaj



dolëm pas pushimit me shumë guxim dhe vetëbesim. Goli i dytë na dëshpëroi, por ishte shumë e padrejtë", ka thënë Mavraj. "AEK-un, si e shikon këtë sezon? Nuk e shikoj fare, s'më intereson. Ambientimi në kampionatin grek? Kampionatin grek e pengojnë shumë gjëra jashtë futbollit. Sot, për shembull, gjyqtari e

prishi ndeshjen fare. Janë disa gjëra që të pengojnë herë pas here. Është një kampionat ndryshe, një përvojë e re për mua dhe një sfidë shumë e madhe. Në ndeshjet që kam luajtur e kam treguar që e kam pranuar këtë kampionat dhe kam treguar veten dhe atë që di të luaj", u shpreh Mavraj për "Sportdog.gr".

Brooklyn pëson humbje nga Golden State

BROOKLYN, 29 TETOR - Golden State korri suksesin e gjashtë në NBA, duke mundur 120-114 Brooklynin jashtë fushës dhe duke marrë kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit. Russell dhe LaVert realizuan 48 pikë së bashku, por që s'mjaf-tuan për ta evituar humbjen, ndërsa në kahun tjetër u dallua dyshja Durant-Curry, që së bashku realizuan 69 pikë. Pa probleme fiton edhe skuadra e Clippersit, që mundi 136-104 Washingtonin, ndeshje e dominuar nga kalifornianët, me 9 lojtarë që realizuan mbi 10 pikë (71 pikë u realizuan nga lojtarët e stolit). Fitoren e parë sezonale arriti ekipi i Oklahomës, që mundi 117-110 Phoenixin, ndeshje e dominuar nga skuadra e Thunderit, që pas 4 humbjes më në fund gjend rrugën drejt suksesit. Një



ndeshje e mirë e Westbrookut dhe Georges, që realizuan nga 23 pikë secili. Ekipi i Utah Jazzit mundi 113-104 Dallasin, një takim me rivalitet dhe emoci- cione, por në periodën e fundit

erdhi shkëputja e Jazzit. Për Dallasin u dallua Smith Jr. me 27 pikë, por që mbetën për statistikë, ndërsa Goberti me 23 pikë e 16 rebaunde ishte më i miri për miqtë.

SHKURT

Hamiltoni: E pabesueshme që barazova rekordin e Fangios

"Jam nga viti 2013 te Mercedesi dhe kur mendoj se arrita ta barazoj rekordin e Fangios, me pesë tituj kampionë bote, ende më duket e pabesueshme. Diçka e jashtëzakonshme. Aktualisht po përjetoj një ndjesi të çuditshme", u shpreh Lewis Hamiltoni, 24 orë pasi është shpallur për të pestën herë në karrierën e tij kampion bote për pilotë në Formula 1. Piloti britanik barazoi rekordin e një legjende të këtij sporti, si Juan Manuel Fangio, ikonë e Formula 1 në vitet '50, ndërkohë që para tij është vetëm një kampion absolut, Michael Schumacher, me 7 tituj kampionë. "Dua ta falënderoj skuadrën pasi, nëse arrita të fitoj këtë Botëror, është falë atyre, pasi janë njerëz që kanë punuar jashtëzakonisht fort", ka thënë Hamiltoni. "Nuk ishte e lehtë, pasi fundjava në Meksikë nisi me të papritura dhe mund të mbyllej e tillë. Madje mund të them që ishte një garë shumë e keqe. Startova mirë, fitova pozicione, por më pas nuk e mora vesh se çfarë ndodhi, djersita shumë për t'i ruajtur pozicionet dhe, para së gjithash, për ta çuar makinën drejt finishit", ka deklaruar Hamiltoni, që mundi në këtë duel për titull ferraristin Sebastian Vettel.

Leicestri konfirmon vdekjen e Presidentit

Leicester City nëpërmjet një komunikate për shtyp konfirmoi vdekjen e Vichai Srivaddhanaprabha, president dhe pronar i klubit. Magnati humbi jetën në një aksident me helikopter ditën e shtunë, në momentin kur po largohej nga "King Power Stadium" pas ndeshjes Leicester - West Ham. Helikopteri humbi kontrollin pasi u ngre dhe u përplas në parkingun e punonjësve të klubit. Kur Leicester luante në shtëpi, 61-vjeçari Srivaddhanaprabha e kishte zakon që të vinte dhe të largohej me helikopter nga stadiumi. Në aksident humbën jetën edhe 4 personat që e shoqëronin pronarin e klubit anglez.

Alba: Ta mposhtësh Realin është si ta fitosh LK-në

Jordi Alba ka thënë se ta mposhtësh Real Madridin është si ta fitoni Ligën e Kampionëve. "Ta mposhtësh Real Madridin është një ndjenjë e njëjtë si ta fitosh Ligën e Kampionëve. Unë gjithmonë i festoj golat, pasi janë speciale për mua, andaj ne vuajmë shumë në minutat e parë të pjesës së dytë", ka thënë Alba. "Jam shumë i lumtur me performancën dhe çdo gjë në jetën time. E ndiej se është një moment shumë i mirë për mua, andaj dua ta shijoj", ka shtuar Alba.

Bakayoko në janar largohet nga Milani

Aventura e Tiemoue Bakayoko me Milanin është drejt përfundimit. Performanca e tij me fanellën kuqezi ka lënë për të dëshiruar dhe drejtuesit e klubit italian nuk do të ushtrojnë të drejtën për blerjen e kartonit nga Chelsea në fund të sezonit. Sipas medieve angleze, 24-vjeçari mund të largohet nga skuadra e drejtuar nga Genaro Gattuso që në janar, duke i mundësuar kështu Leonardos të kursejë shumë nga paga e madhe e lojtarit, duke i futur ato para në merkato për ta bindur Cesc Fabregasin të transferohet në Milanello.

Sandro nuk e vazhdon kontratën me Juven

Mbrojtësi i krahut të majtë i Juventusit, Alex Sandro, ka kontratë me skuadrën italiane deri në qershor të vitit 2020 dhe lojtari nuk ka pranuar që ta vazhdojë atë sipas lajmeve të fundit. Sandro është një lojtar mjaft i rëndësishëm për Massimiliano Allegrin, ku deri më tani është paraqitur 13 herë në këtë stinor. "Zonja e Vjetër" pagoi rreth 26 milionë euro për ta sjellë atë nga Porto dhe tani është duke marrë oferta të mëdha për shërbimet e brazilianit. Alex Sandro thuhet se e ka refuzuar vazhdimin e kontratës momentalisht, pasi kërkon kohë që të mendoj për të ardhmen e tij, kur për të interesim të madh kanë Paris Saint-Germaini dhe Manchester City.

REZULTATET

Brooklyn - Golden State	114-120
Dallas - Utah Jazz	104-113
Oklahoma - Phoenix	117-110
Clippers - Washington	136-104



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NJOFTIM

Të gjithë investitorët potencial që planifikojnë të ofertojnë në

Shitjen 42

të aseteve të ndërmarrjeve në Likuidim, njoftohen se dita e dorëzimit dhe hapja e ofertave është:
e mërkurë **07 nëntor 2018**, prej orës **10:00 - 12:00**, në **Sallën e konferencave të Hotelit Grand, në Prishtinë.**

Njësia nr.01: Pasuria Bujqësore Toka në Sojevë	Njësia nr.28: Ratar Tokë Bujqësore Graçanicë II
Njësia nr.02: KB Zhegra Toka në Lladovë	Njësia nr.29: Ratar Tokë Bujqësore Graçanicë III
Njësia nr.03: KB Zhegra Toka në Zhegër	Njësia nr.30: Ratar Tokë Bujqësore Livagjë
Njësia nr.04: Agromorava Toka në Sllatinë të Poshtme (Lot C)	Njësia nr.31: Ratar Tokë Bujqësore Uglar I
Njësia nr.05: Agromorava Toka në Viti (Lot C)	Njësia nr.32: Ratar Tokë Bujqësore Uglar II
Njësia nr.06: IMK Fabrika e Tubave Lokali në Ferizaj	Njësia nr.33: Ratar Tokë Bujqësore Uglar III
Njësia nr.07: Kualiteti Lokali në Gjilan	Njësia nr.34: KB Flora Tokë Bujqësore Dobërdol
Njësia nr.08: Pasuria Bujqësore Toka në Kosinë (Lot B)	Njësia nr.35: KB Kosova Tokë Bujqësore Livagjë IV
Njësia nr.09: Agrokultura Toka në Gjilan (Lot M)	Njësia nr.36: Visoko Commerce Shitorja nr. 2
Njësia nr.10: Pasuria Bujqësore Toka në Tankosiq (Lot A)	Njësia nr.37: Marketing Export Lokali Lipjan
Njësia nr.11: Produkti Parcelat 00851-0 dhe 00852-0 në Klinën e Epërme	Njësia nr.38: Bujqësia Tokë Bujqësore Uglar II
Njësia nr.12: Produkti parcelat 755-0 dhe 797-0 në Kopiliq i Poshtëm	Njësia nr.39: NSH Lavërtari Blegtori - Tokë Bujqësore në Trepetincë 8
Njësia nr.13: NSH Produkti Tokë në Dashevc	Njësia nr.40: NSH NBI Rahoveci - Prona në Hoqë të Madhe 5
Njësia nr.14: Elan Parcela 114-1 ZK Stanovc i Epërm/Përronaj	Njësia nr.41: NBI Rahoveci - Prona në Ratkoc 1
Njësia nr.15: Lokali Afarist nr.2	Njësia nr.42: NBI Rahoveci - Prona në Ratkoc 2
Njësia nr.16: Lux Lokali "Nashe Dete"	Njësia nr.43: NBI Rahoveci - Prona në Ratkoc 4
Njësia nr.17: Toka në Gërgoc	Njësia nr.44: NSH Zadruga Shterpce - Tokë bujqësore në Biti të Epërme 6
Njësia nr.18: Parcela nr.239 në Gërgoc	Njësia nr.45: NSH Zadruga Shterpce - Tokë bujqësore në Biti të Epërme 7
Njësia nr.19: Parcela nr.726-3 në Gllarevë	Njësia nr.46: NSH Zadruga Shterpce - Tokë bujqësore në Biti të Epërme 8
Njësia nr.20: Toka Bujqësore Damjan 4	Njësia nr.47: NSH Lavërtari Blegtori - Tokë Bujqësore në Lutogllavë
Njësia nr.21: Parcelat 300-1 dhe 300-2 në Lubovë	Njësia nr.48: NSH Lavërtari Blegtori - Tokë Bujqësore në Lubizhdë 5
Njësia nr.22: Parcela nr.239 në Kosuriq	Njësia nr.49: NBI Suhareka - Parcela në Sallagrazhdë 3
Njësia nr.23: Toka në Kosuriq	Njësia nr.50: NSH D.L.B Lavërtaria-Blegtoria - Tokë bujqësore në Korishë 2
Njësia nr.24: Parcela nr. 1-26 në Ramun	Njësia nr.51: NSH Zadruga Shterpce - Toka bujqësore Vërbeshtica 2
Njësia nr.25: NSH Kooperimi - Tokë bujqësore Vitomirica 1	Njësia nr.52: NT Koritniku Shitorja në fshatin Orqushë, Dragash
Njësia nr.26: KB Dubrava - Toka bujqësore në Gurrakoc	Njësia nr.53: NSH Podrima - Shitorja nr.4 në Rahovec
Njësia nr.27: NSH Deva ngastra kadastrale nr.705 ZK Devë	

* Të gjithë ofertuesit potencial të cilët planifikojnë të dorëzojnë ofertën për asetet e përfshira në **Shitjen nr. 42 të Aseteve** janë të obliguar që të përdorin dhe të plotësojnë në tërësi VETËM shtojcat të formatin e përfshirë në **Rregullat e Tenderit** në fuqi, përndryshe oferta e tyre mund të **DISKUALIFIKOHET!**
Formularët mund të shkarkohen në ueb faqen e AKP-së apo të tërhiqen në zyrën e marketingut në AKP.

Për më shumë kontaktoni - Njësinë për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitorë
Rr. Agim Ramadani Nr. 23, (ish Rr. Ilir Konushevc Nr.8), 10 000 Prishtinë, Kosovë
tel: +383 (0) 38 500 400, lok. 2004, 1090, 1105 ose 1152 / fax +383 38 248 076
e-mail: shitja@pak-ks.org ose sales@pak-ks.org; www.pak-ks.org

Informatat që janë dhënë në këtë publikim mund të kenë pasaktësi, lëshime, ose gabime tipografike për të cilat Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk do të jetë në asnjë mënyrë përgjegjëse e as nuk do të pranojë përgjegjësi lidhur me përdorimin, vlefshmërinë, saktësinë, plotësinë ose besueshmërinë, pa marr parasysh natyrën e tyre.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/MINISTRIA E SHËNDETËSISË
VLADA KOSOVA/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA
GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF HEALTH
Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
(AKPPM)
Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva (KALIMS)
Kosova Medicines Agency (KMA)



Duke u bazuar në Ligjin e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale shpall këtë:

K O N K U R S

1. Titulli i punës : Një (1) Zyrtarë i lartë i Divizionit për narkotikë dhe prekursorë
Referenca : 04/2018
Lloji i pozitës : Marrëveshje mbi shërbimet e veçanta deri në (6) muaj
Orari i punës : 40 orë në javë Koef. 8
Mbikëqyrësi : Udhëheqësi i Divizionit për narkotikë dhe prekursorë
Vendi : AKPPM-Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Mbikëqyrja administrative e qarkullimit të narkotikëve dhe prekursorëve

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Evaluimi i aplikacioneve për operim me narkotikë dhe prekursorë
2. Evaluimi i aplikacioneve për import/eksport të narkotikëve dhe prekursorëve;
3. Mbanë evidencë lidhur me operuesit me narkotikë dhe prekursorë dhe lidhur me sasinë e importuar/eksportuar të secilit produkt narkotikë dhe prekursorë;
4. Pranon raportet 3 mujore nga operuesit me narkotikë, të cilat i analizojnë dhe nxjerr përfundimin e konsumit të përgjithshëm;
5. Njofton dhe këshillon palët për risitë në procedurat e aplikimit;
6. Identifikimi i problemeve dhe njoftimi i mbikëqyrësit direkt për problemet e identifikuar.
7. Në mungesë të zyrtarëve të caktuar, kryen detyrat e parashtruara nga ana e shefit të divizionit ose drejtorit të departamentit të licencimit.

Kualifikimi

Farmacist, mjek, biolog, kimist, përvojë së paku 2 vjeçare në lëmitë që përkojnë me këtë veprimtari.

Shkathësitë

- Komunikative, organizative, veprimi edhe nën presion, punë ekipore;
- Njohuri të elementare për kompjuter;
- Njohja e gjuhëve zyrtare ose angleze.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Formulari për aplikim mund të merret në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, Zyra e Personelit, (Adresa: Rrethi i Spitalit, QKUK, 10000, Prishtinë), ku edhe dorëzohen pas plotësimit. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Personelit në numrin e telefonit: **038/20024243** prej orës **08:00-16:00**. Formulari zyrtar i konkurrencës duhet të dorëzohet së bashku me dëshminë për kualifikim shkollor, kurset e ndjekura, përvojën e punës, certifikatën (dëshminë) që s'është nën hetime dhe dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

"Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjithë komunitetet e Republikës së Kosovës".

"Komuniteti jo – shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati nuk do të shqyrtohen fare.

Kandidatët të cilët hynë në përzierje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga personeli.

Afati i konkursit është i hapur 8 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor (prej datës: 30.10.2018 deri më datën: 06.11.2018 në ora 16:00).



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/MINISTRIA E SHËNDETËSISË
VLADA KOSOVA/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA
GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF HEALTH
Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
(AKPPM)
Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva (KALIMS)
Kosova Medicines Agency (KMA)



Na osnovu Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosova, br. 03/L-149 i Uredbe br.02/2010 za procedurë zapošljavanja u civilnoj službi Republike Kosova, Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva objavljuje:

K O N K U R S

1. Naziv radnog mesta: Jedan (1) Visoki službenik Odeljenja za narkotike
Referenca : 04/2018
Vrsta pozicije : Sporazum o posebnim uslugama do (6) meseci
Radno vreme : 40 sati nedeljno Koef. 8
Nadzornik : Šefa Odeljenja za Narkotike
Mesto : KALIMS-Prishtina

Svrha radnog mesta:

Administrativni nadzor nad prometom narkotika i prekursora

Zadaci i odgovornosti:

1. Evaluacija aplikacije za operiranje sa narkoticima i prekursorima;
2. Evaluacija aplikacija za uvoz/ izvoz narkotika i prekursora;
3. Drži evidenciju za kompanije koja operiraju narkoticima i prekursorima u vezi sa uvozom / izvozom količinom svakog opojnog proizvoda i prekursora;
4. Prihvata 3 mjesečnih izveštaje od operatora narkotika, koji analizira i izdaje ukupnu potrošnju;
5. Obaveštava i savetuje stranke o inovacijama u procedurama podnošenja zahteva;
6. Identifikuje probleme i obavesti nadzornika o identifikovanim problemima.
7. U odsustvu drugih službenika, obavlja i druge dužnosti definirani od strane šefa odeljenja ili direktora departamena.

Kvalifikacije

Farmaceut, lekar, biolog, hemičar, sa iskustvom od najmanje 2 godine u poljima koja se podudaraju sa ovom aktivnošću.

Veštine

- Komunikativan, organizacione, rad pod pritiskom, timski rad
- Osnovno znanje računara
- Poznavanje službenih jezika ili engleskog jezika

Uzimanje i podnošenje aplikacija:

Obrazac za aplikaciju može se dobiti u Kosovskoj Agenciji za Lekove i Medicinska Sredstva, kancelarija Ljudskih Resursi, (Adresa: Rrethi i Spitalit, QKUK, 10000, Prishtina), gde mogu se dostaviti posle popunjavanja obrazaca. Za detaljnije informacije možete kontaktirati sa kancelarijom Humanih Resursa u broj telefona: **038/20024243** od **08:00-16:00**.

Službeni obrazac za konkurisanje treba da se dostavi zajedno sa dokazom o školskoj kvalifikaciji, završeni tečajevi, radno iskustvo, sertifikat (dokaz) da nije pod istragom i dve referencije. Upotreba pogrešnog i nekompletiranog obrazca sa potrebnim podacima smatrat će se nevažećim.

"Civilna Služba Republike Kosove pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosova i dočekuje aplikacije od muškaraca i žena od svih zajednica Republike Kosova".

"Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo da budu predstavljeno pravedno i proporcionalno u organima civilne službe Javne Administracije na lokalnom i centralnom nivou, kao što je naznačeno u Čl.11, stav 3 Zakona Br. 03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova".

Aplikacije poslate poštom, koja nose poštanski žig na pošiljci na poslednji dan roka za podnošenje aplikacije, smatrat će se važećim i biće uzete u obzir ako stigne u roku od 3 dana. Prijave koje pristiglnu nakon tog roka neće biti razmatrane uopšte.

Kandidati koji budu ušli u uži izbor za intervju bit će obavesteni pismenim putem ili putem telefona u zakonskom roku od strane personela.

Rok za konkurs je otvoren 8 dana od dana objavljivanja u novinama (od datuma: 30.10.2018 do datuma: 06.11.2018 u 16:00).



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria -Vlada-Government
 MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
 AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
 AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:583/1

Dt: 29.10.2018

NJOFTIM

ANULOHET konkursi për pozitën:

1. Zyrtar/e profesional (Marrëveshje me Shërbime të Veçanta) në Agjencinë e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur i shpallur me dt.11 .10.2018 me nr. 564/1.

Nga pjesëmarrësit në konkurs kërkojmë mirëkuptim.



OFERTË PËR SHITJE TË SHTËPISË

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m2, dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m2.

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi.

Çmimi sipas marrëveshjes.

Informata më të hollësishme mund të merren në numrin e telefonit 001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë në celularin 044-166-580.

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"



**Auto Shkolla
 "RITMO - L"
 Prishtinë**

**Eksperiencia jonë
 - përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
 Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:
 044 248 173
 044 200 604
 044 375 333**

Njoftim per shprehje interesi

Blerja dhe vendosja e televizoreve(monitor),llap-top,kablo ,perde dhe korrektor

Emri i shkollës: "Beqir Gashi"

Komuna: Malishevë

Data:29.10. 2018

Emri i kontratës:**Blerja dhe vendosja e televizoreve(monitor),Llap-top,kablo,perde dhe korrektor**

Numri i kontratës: ESIP/C1.3/050-ESIP/SDG/050/G/1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles "Beqir Gashi", Mleqan-Malishevë. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

Televizor(monitor)— 5 cope
-Llap-top— 2 cope

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë të shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën Adresa e Shkolles "Beqir Gashi" Mleqan- Malishevë më së largu deri më **06.11.2018**.

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Fehmi Kryeziu,Zenel Shala

Telefoni: 044365635 ,044408451

E-maili: fehmi6@hotmail.com

(emri i personit përgjegjës kontaktues për pakon në fjalë, numri i telefonit dhe adresa elektronike).

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Metin Süleyman,shpall te pavlefshme diplomën e Shkollës së Lartë të Arsimit të Mesëm - viti 2010, leshuar nga Gjimmazi "Sami Frashëri", Prishtinë.

► "Airkos" SH.P.K. shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr: 810166505.

► Ilire Uruqi nga Gjilani, shpallë të humbur certifikatën e pjesëtares së UÇK-së me nr. 002118.

► Riad Ramadani nga Prishtina, shpallë të humbur diplomën e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike Bachelor dhe Master Prishtinë.

► "Tech 4 IT" SH.P.K. shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 71243435 me seli në Prishtinë.

► Nedzat Aljiti shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Fikrim Menekashe shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Shacir Shala shpall te pavlefshme dëftesat e diplomën certifikatat SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Gulzade Besnik shpall te pavlefshme diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren.

► Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbulë Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuar i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkohet kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë e përshtatshme dhe për banim kolektiv. Tel. 044-413-197, wiber: 045-198-095.

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

Lëshoj shtëpinë me qira, e cila gjendet në lagjen e "Universiteti" përball rrugës B dhe përball marketit Viva Fresh Store. Shtëpia është 100 metra katror dhe e mobiluar. Është e përshtatshme për zyre dhe banim. Numri kontaktues 049-574-169.

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

Prishtinë



ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

